

Parlamenti Evropian (EP)

www.europarl.eu.int/home/default_de.htm

Roli Juaj si anëtar i Parlamentit Evropian

Që prej zgjedhjeve të para të drejtpërdrejta parlamentare të vitit 1979 Parlamenti Evropian është institucioni i parë i Bashkimit Evropian i zgjedhur direkt nga qytetarët. Zgjedhjet për në Parlamentin Evropian zhvillohen çdo pesë vjet. Që prej zgjerimit të BE-së me Rumaninë dhe Bullgarinë më 1 janar 2007 Parlamenti Evropian përbëhet nga 785 deputetë, që vinë këtu jo sipas vendeve të tyre të origjinës, 27 shteteve anëtare të BE, por organizohen në grupime të ndryshme politike, si p.sh. në „Fraksionin e Partive Popullore Evropiane (PPE)“ ose në „Fraksionin e të Gjelbërve“ (shih më poshtë). Pothuaj të gjitha fraksionet kanë lidhur ndërkohë marrëdhënie me partitë e orientimeve të tyre politike në vendet kandidatë duke i përfshirë në strukturat e tyre në nivel evropian.

Procesi i vendimmarrjes në Bashkimin Evropian është i ndarë në mënyrë ekzakte mes institucioneve të Komunitetit (Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian) dhe qeverive të shteteve anëtare.

Këshilli i Bashkimit Evropian përbëhet nga ministrat e shteteve anëtare dhe vepron si organ legjislativ (pushtet ligjvënës) dhe si organ ekzekutiv (pushtet zbatues). Qendra e veprimtarisë së tij është gjithsesi ligjvënja, pasi vec disa rasteve të pakta përjashtimesh Këshilli ia kalon Komisionit të drejtën për të vënë në zbatim ligjet e miratuara. Pas kësaj **Komisioni Evropian** zakonisht përcakton dispozitat ligjore të nevojshme për zbatimin e akteve ligjore të miratuara.

Në varësi të procedurave të aplikuara për vendimmarrje Parlamenti Evropian ka pak a shumë të drejtë bashkëvendosjeje në ligjvënien evropiane.

Në rastin e një zgjerimi të Bashkimit Evropian në mbyllje të procedurave është i nevojshëm miratimi i Parlamentit Evropian.

Për këtë arsye **Këshilli i Bashkimit Evropian** nuk mund ta anashkalojë **Parlamentin Evropian** në një rast vendimmarrjeje, por duhet që gjithmonë të mbajë në konsideratë pozicionin e tij.

Numri i vendeve në Parlamentin Evropian sipas fraksioneve (Stadi: 1 shtator 2007)

Fraksioni	Shkurtimi	Numri i vendeve
Fraksioni i Partive Popullore Evropiane (Kristiandemokratët) dhe Demokratët Evropianë	PPE-DE	278
Fraksioni i Partive Socialdemokrate të Parlamentit Evropian	PSE	216
Fraksioni i Aleancës së Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën	ALDE	104
Fraksioni i Bashkimit për një Evropë të Kombeve	BEK	44
Fraksioni i të Gjelbërve / Aleanca e Lirë Evropiane	Të Gjelbërit/ALE	42
Fraksioni Federal i të Majtës së Bashkuar Evropiane / e Majta e Gjelbër e Veriut	MBE/MGjV	41
Fraksioni i Pavarësisë/Demokracisë	IND/DEM	24
Identitet, Traditë, Sovranitet	ist	23
Pafraction dhe vende vakante	pf	13
Gjithsej		785

Parlamenti Evropian është një forum publik i shprehjes së mendimit dhe një organ bashkëvendosës i Komunitetit. Një interes i rëndësishëm mbifraksional është përforcimi i strukturave demokratike të Bashkimit Evropian dhe të procesit të bashkimit. Në fakt Parlamenti Evropian ka mundur t'i zgjerojë funksionet e tij në disa etapa, por nuk zotëron ende funksione të krahasueshme me ato të parlamenteve kombëtare. Duke qenë se Parlamenti Evropian zgjidhet nga qytetarë dhe qytetarë të shteteve anëtare, ai konceptohet si një model demokratik i Unionit dhe si përfaqësi e interesave të qytetarëve të vet. Vetë Parlamenti nuk ka të drejtën të marrë iniciativa, pra nuk lejohet të bëjë propozime për zgjerimin e BE-së. Pra edhe këtu qëndron një ndryshim shumë i dukshëm mes Parlamentit Evropian dhe atyre kombëtare.

Vendimtare për vendimmarrjen në Parlamentin Evropian nuk janë interesat kombëtare, por linjat politike që ndjekin fraksionet përkatëse, të cilat janë formuar dhe ekzistojnë në nivel evropian.

Shpërndarja e vendeve sipas shteteve (Legjislatura 2009–2014)

Belgjika	24	Hollanda	27
Bullgaria	18	Austria	18
Danimarka	14	Polonia	54
Gjermania	99	Portugalia	24
Estonia	6	Rumania	35
Finlanda	14	Suedia	19
Franca	78	Slllovakia	14
Greqia	24	Sllovenia	7
Irlanda	13	Spanja	54
Italia	78	Republika Çeke	24
Letonia	9	Hungaria	24
Lituania	13	Mbretëria e Bashkuar	78
Luksemburgu	6	Qipro	6
Malta	5		785

Megjithë fjalimet euforike mbi Evropën europarlamentarët nuk përfaqësojnë të gjithë të njëjtin opinion. Kontroversiteti i raportit „Thellim apo zgjerim i BE-së“ përshkon të gjitha fraksionet e Parlamentit Evropian.

Parlamenti Evropian (EP) ndryshon dukshëm nga parlamentet ndërkombëtare (si p.sh. nga Bundestag-u gjerman), pasi zoteron vetëm disa **kompetenca të kufizuara parlamentare**. Të drejtat që zotëron Parlamenti Evropian në kuadër të procedurave ligjvënëse varen kryesisht nga fusha politike, ku do të merret vendimi. Këto të drejta shtrihen nga njoftimi dhe seancat dëgjimore deri në bashkëpunimin në ligjvënien evropiane. Përmes Politikës buxhetore Parlamenti Evropian mund të ushtrojë ndikim edhe mbi disa fusha të rëndësishme të politikës. Në rastin e Politikës së Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë si dhe në atë të Bashkëpunimit në Drejtësi dhe Punët e Brendshme Parlamenti Evropian ka vetëm të drejtën e seancave dëgjimore dhe të njoftimit të Këshillit. Shumë më e fuqishme është kompetenca parlamentare p.sh. në pranimin e vendeve të tjera në BE (Procedura e miratimit, neni 49 i Marrëveshjes mbi BE), procedura e bashkëvendosjes (neni 251), që gjen zbatim p.sh. në arsim apo kërkimet shkencore ose në procedurën e bashkëpunimit (neni 252), që gjen zbatim në politikën për mjedisin.

Si deputet/e i/e Bashkimit Evropian në punën Tuaj Ju mbani në konsideratë edhe zërat dhe tendencat në vendin Tuaj. Krahas përkatësisë Suaj partiake Ju ndiheni i detyruar edhe përkundrejt interesave të elektoratit Tuaj dhe premtimeve Tuaja zgjedhore.

Duke qenë se vendimet në BE merren nga Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, atëherë për anëtarët e Parlamentit Evropian është e pashmangshme lidhja e kompromiseve me fraksionet e tjera, në mënyrë që të ushtrojnë më pas presion mbi Këshillin. Për këtë arsye rekomandohet, që koha mes seancave dhe diskutimeve në Këshill të shfrytëzohet për biseda me kolegë të tjerë për të gjetur një pozicion të pranueshëm. Që pozicioni Juaj në Parlamentin Evropian të jetë ai i shumicës, keni nevojë për mbështetjen e fraksioneve të tjera.

Për tu arritur shumica e cilësuar shpesh është e nevojshme që partitë e mëdha në Parlamentin Evropian të arrijnë një marrëveshje mes tyre. Ju duhet të mbani parasysh, që çdo vendim, që Ju mbështesni, apo çdo koment a veprim politik ka efektet e veta në zgjedhësit dhe zgjedhëset Tuaj/a dhe mund të dëmtojë rizgjedhjen Tuaj në Parlament. Krahas kësaj në veprimtarinë Tuaj politike nuk duhet të harroni asnjëherë mediat!

Si anëtar i Parlamentit Evropian duhet domosdoshmërisht të përpiqeni për të çuar përpara integrimin evropian dhe efektet e tij për politikën e përditshme. **Parlamenti Evropian ndërkohë është shndërruar në një shembull për institucionet dhe organizatat e tjera në botë në menyrë të veçantë lidhur me të drejtat e njeriut, politikat për mbrojtjen e mjedisit, marrjen në konsideratë të dimensionit social të tregut të brendshëm, dhe mbrojtjen e konsumatorit.** Ndaj duke qenë anëtar i këtij Parlamenti nuk do të ishte në interesin Tuaj nëse imazhi i tij eventualisht do të dëmtohej. Bashkimi Evropian duhet të zhvillohet dhe shndërrohet më tej në një strukturë politike demokratike dhe të aftë për të vepruar.

Në Plan-Lojën tonë ekzistojnë maksimumi shtatë fraksione. Ju do të jeni anëtar ose i fraksionit të Partive Popullore Evropiane (PPE), fraksionit të Partive Social-Demokrate të Evropës (PSE), fraksionit të Të Gjelbërve në Parlamentin Evropian (Të Gjelbërit), të fraksionit të Partisë Liberale dhe Demokratike (ALDE), fraksionit të Bashkimit për një Evropë të Kombeve (UEN), Fraksionit Federal të të Majtës së Bashkuar Evropiane / të Majtës së Gjelbër të Veriut (VEL/NGL) ose do të jeni pa fraksion (pf). Është e qartë që si anëtar i Parlamentit Evropian Ju përfaqësoni idetë politike të fraksionit Tuaj dhe përpiqeni të realizoni pozicionet Tuaja politike në vendimmarrjet e Parlamentit Evropian.

E rëndësishme: Varet vetëm nga Ju, se si do ta luani rolin Tuaj si anëtar i Parlamentit Evropian. Ju mund të mbështesni iniciativa të caktuara, por pozicioni Juaj Ju mundëson edhe bllokimin e planeve të ndryshme. Ju mund të shfrytëzoni mediat për konsolidimin e pozicionit Tuaj poliitik, madje mund të ndryshoni edhe kampin politik ku bëni pjesë. Vetëm Ju mund të vendosni, se ç'është më e mira për Ju dhe zgjedhësit Tuaj!

Për kujtesë: Cili është roli i Parlamentit Evropian në lidhje me zgjerimin?

Neni 49 (Ex-Artikel O) Marrëveshja mbi BE – pranimi i shteteve të tjera anëtare

„Çdo shtet evropian [...] mund të bëjë kërkesën për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kërkesa i dorëzohet Këshillit i cili duhet të vendosë njëzëri pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian, i cili merr vendimin e vet me shumicë absolute (shënim i autorit: të paktën 50% +1 të të gjithë deputetëve).“

Udhëzim: Për arsye teknike të lojës simulohet vetëm një seancë e Komisionit për Punët e Jashtme!

Detyrat Tuaja si anëtar i Parlamentit Evropian gjatë simulimit:

1. Përpunoni rolin Tuaj me ndihën e profilit të roleve; në fjalën e hapjes së Presidentit të Komisionit Evropian ekziston mundësia e realizimit të disa kontakteve të para informale.
2. Zgjidhni kryetarin me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1 e të pranishmëve). Sqaroni dhe miratoni rregulloren e brendshme (kohët mbajtjes së fjalës, rrjedhën, protokollin (Kap. V-M 4.). Jepni një deklaratë personale (cdo tre minuta).
3. Pranoni kërkesat për anëtarësim dhe këshilloni në seancën e parë të Komisionit të Jashtëm
4. Jepni një konferencë të parë për shtyp.
5. Mbi bazën e kërkesave përpunoni një pozicion të përbashkët (Kap. V-M 11.).
6. Ftoni të deleguar të vendeve anëtare për paraqitjen e kërkesave të tyre dhe dëgjoni prezantimet përkatëse. Formuloni pozicionin Tuaj dhe ia kaloni Këshillit.
7. Komisioni Ju informon në lidhje me vijimin e bisedimeve dhe Ju keni mundësinë për të zhvilluar biseda me shtypin.
8. Komisioni i Jashtëm i Parlamentit Evropian simulon një seancë plenare të Parlamentit. Pozicionimi i Komisionit të Jashtëm do të jetë baza e vendimmarrjes së Parlamentit. Parlamenti Evropian, I cili duhet të vendosë me shumicë absolute të anëtarëve të tij, që do të thotë për një rezultat pozitiv duhet të mbledhen të paktën 50% +1 të anëtarëve të Parlamentit që të realizohet marrëveshja përkatëse. Përfaqësuesit e vendeve kandidate janë të ftuar në procesin e votimit.
9. Ju keni mundësinë të përgatisni fjalime për konferencën e ceremonisë së pranimit.
10. Konferencën e përbashkët të pranimit do të ketë dy deputetë, që do të mbajnë një fjalë me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së anëtarësimit dhe do të jenë të gatshëm për intervista apo një Talkshow të mundshëm.

Fraksioni „Partia Popullore Evropiane – Demokratët Evropianë“ në Parlamentin Evropian (PPE-DE)

www.epp-DE.org

Partia Popullore Evropiane është një bashkim partish, që kanë në bazë të tyre vlerat dhe traditat kristian-demokrate. Ajo kërkon të realizojë vlera bazë, që mbështeten në dinjitetin e patjetërsueshëm dhe të paprekshëm të njeriut: liria, barazia e shanseve, drejtësia sociale dhe solidariteti aktiv. Liria e njeriut argumenton të drejtën dhe detyrimin e gjithësecilit, për të mbajtur përgjegjësinë e veprimeve dhe vendimeve tona si dhe bashkëpërgjegjësinë përkundrejt bashkëqytetarëve tanë dhe botës. Në këtë sens PPE e konsideron veten si një parti politike të vlerave. PPE-DE mbështet një BE të njësuar dhe funksional, në mënyrë që të mbështetet stabiliteti i Kontinentit dhe të kontribuohet në forcimin e Evropës në botë. Bashkimi Evropian duhet të zhvillohet më tej nga qytetarët dhe qytetarët e vet/a.

Politika e Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë (PPJS) në kuadrin e BE nuk duhet të kufizohet në terma afatgjatë vetëm në bashkëpunimin mes qeverive, por duhet shndërruar në një politikë të vërtetë komuniteti në sektorë të interesit të përbashkët. Për çështjet që kanë të bëjnë me realizimin e PPJS duhen marrë vendime me shumicë të cilësuar. Në këtë kontekst Parlamentit Evropian i duhen lënë të drejta vendimtare kontributi dhe kontrolli. Përmes krijimit të instrumentave të përshtatshëm PPJS duhet vënë në një gjendje të tillë që të zhvillohet në një Union evropian sigurie me një politikë të përbashkët mbrojtjeje.

BE duhet të mbetet e hapur për shtete të tjera evropiane, të cilat kërkojnë të ndertohen dhe zhvillohen më tej në shtëpinë e përbashkët evropiane, pasi vetëm zgjerimi nuk lejon një ndarje të re të Evropës. Kusht për këtë është që vendet kandidatë të marrin përsipër të respektojnë sistemin e vlerave të BE-së dhe ta praktikojnë atë në kuadër të një demokracie parlamentare dhe pluraliste. Ato duhet të orientohen nga parimet e ekonomisë së tregut me karakter social dhe të jenë të gatshme të marrin pjesë në të gjitha projektet, për të cilat është rënë dakord bashkarisht. Me zgjerimin duhet të shkojë paralel edhe thellimi i këtyre vlerave, që duhet të pengojë para së gjithash shkatërrimin e demokracisë brenda BE-së.

Zgjerimi i synuar kërkon edhe një analizë parimore në lidhje me kufijnjtë e këtij procesi dhe bën të domosdoshme ndryshimet institucionale. PPE-DE synon largimin nga metoda e deritanishme e negociatave qeveritare, zgjerimin e procedurave të bashkëvendosjes dhe të vendimmarrjes mbi bazë shumice në kuadër të Këshillit si dhe kufizimin e kompetencave si mes insitucioneve evropiane po ashtu edhe mes Evropës, kombeve dhe rajoneve në formën e një marrëveshjeje kushtetutore. PPE sheh si objektiv të BE-së arritjen e një Bashkimi Evropian Federal.

Një hapje krejtësisht e nxituar e bisedimeve të anëtarësimit me Turqinë, në gjykimin e PPE-DE, ka ndikuar dukshëm në rritjen e pasigurisë dhe të humbjes së orientimit përkundrejt strategjisë së ardhshme të BE-së në lidhje me zgjerimin. Prej shumë vitesh ky fraksion kërkon me forcë që të mos ketë zgjerim të BE-së pa patur një reformë institucionale të tij. Ky pozicion gjeti shumë vonë vesh të hapur te shtetet anëtare - vetëm me konventën për Kushtetutën - por deri më tani nuk është realizuar. Së këtijmi të arrish të nxjerrësh përfundimin, që edhe pas plotësimit të kriterëve nuk lejohen më pranime të tjera, kjo do të ishte fatale. Përkundrazi duhen krijuar instrumentat, që na lejon Kushteta e BE-së, për të rimëkëmbur kapacitetet pranuese të BE-së. Pa reforma insitucionale pranimiti i shteteve të reja vështirë se është i mundur.

Të gjitha shteteve të Ballkanit u duhet ofruar mundësia e pranimit në BE. Angazhimi i konsiderueshëm i BE-së deri më tani në Ballkan duhet vijuar në mënyrë konsekuente dhe të mirëorientuar me hapat e përafritit të këtyre vendeve me BE-në. Nga perspektiva e fraksionit kjo ka qenë dhe është, pas ngjarjeve të tmerrshme në ish-Jugosllavinë, një motor i rëndësishëm për ndryshime të nevojshme. Pasi një vështrim i thjeshtë mbi hartë tregon: ky rajon shtrihet në mes të Evropës, kështu që stabiliteti i tij është edhe stabiliteti i Evropës.

Vendimtare është që shteteve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore t'u ofrohet perspektiva e një integrimi gradual në Bashkimin Evropian, në mënyrë që në këto vende të mund të përforcohen strukturat për një shoqëri demokratike dhe një sistem shtetëror modern. Mbështetja për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore duhet të drejtohet vecanërisht për nga zhvillimi i një ekonomie tregu me karakter social dhe të orientuar ekologjikisht.

Pranimi i Turqisë është i diskutueshem edhe nga ky fraksion për shkak të çështjeve të të drejtave të njeriut. E megjithatë ka edhe zëra, që thonë se Turqia, duke qenë se është një vend mysliman, për shkaqe fetare dhe kulturore, nuk ka vend në civilizimin evropian.

Detyra Juaj si anëtar i fraksionit

Përfytyroni, se jeni anëtar i fraksionit. Si forcë politike e qendrës, për balancën dhe ekonominë e tregut me karakter social PPE-DE ka qenë gjithnjë një ndër fraksionet më të mëdha në Parlamentin Evropian. Që prej zgjedhjeve të fundit madje ajo është forca më e madhe në Parlamentin Evropian. Në këtë mënyrë Ju do të keni një ndikim të konsiderueshëm në të gjitha diskutimet në plenum. Por gjithsesi nuk keni shumicën, ndaj edhe nuk jeni në gjendje të reagoni vetëm ndaj të gjitha iniciativave të Komisionit. Për këtë arsye bashkimi brenda për brenda fraksionit do të ishte i rëndësishëm.

Për këtë Ju keni natyrisht nevojë edhe për mbështetjen e fraksioneve të tjera politike dhe në analizat Tuaja duhet të mbani në konsideratë faktin që edhe fraksioni i Partisë Socialdemokrate të Evropës është gjithashtu një fraksion shumë i forte, që mund të bllokojë me lehtësi iniciativat Tuaja, nëse nuk keni mundur të gjeni mbështetjen e grupimeve të tjera më të vogla. Ndaj varet nga Ju të gjeni rrugën e mesme të duhur. Pasi nga njëra anë duhet të kërkoni një kompromis, që mund të shndërrohet në detyrën e profilit politik, nga ana tjetër fiksimi në pozicionet Tuaja mund të çojë në një dobësim të ndikimit të Parlamentit Evropian, nëse Ju nuk mund të gjeni gjuhën e përbashkët me kolegët Tuaj. Në këtë mënyrë, në fund, vendimi do të ishte në duart e Komisionit dhe Këshillit të Bashkimit Evropian.

Në çdo fraksion ka ekspertë për sektorë të veçantë të politikës, Ju bëni pjesë në Komisionin për Punët e Jashtme dhe përpunoni kryesisht çështje të formësimit të ardhshëm të një Bashkimi Evropian në proces shndërrimi dhe zgjerimi. Është në dorën Tuaj të vini nën një dritë kritike shanset dhe risqet e zgjerimit të BE-së me shtete të Evropës Juglindore, dhe detyra Juaj është të merreni vesh me anëtarë të tjerë të PPE-DE në lidhje me pozicionimin e përbashkët përse i përket çështjes së zgjerimit. Krahas kësaj Ju do të nisni të kërkoni mbështetës nga fraksionet e tjera, të formoni koalicione të mundshme dhe të diskutoni në mënyrë kontroverse tematikat në Parlament, në mënyrë që të bindni kundërshtarët Tuaj politikë për konceptin politik që Ju paraqisni. Por jini të vetëdijshëm: Nuk ka kuptim të flisni pa dëgjuar. Në mënyrë që puna e Parlamentit Evropian të jetë efektive duhet të punoni për të arritur një kompromis, me qëllim që të mund të keni sukses edhe në propozimet e Këshillit të BE-së, të cilat eventualisht mund të mos përputhen me linjën e Parlamentit Evropian.

Deputetet/ët e PPE-DE nga Republika Çeke në Parlamentin Evropian

Që prej datës 1 maj 2004 Republika Çeke është anëtare e Bashkimit Evropian. Ajo u pranua së bashku me shtete të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. Kështu u realizua rasti më i madh dhe sigurisht më i vështiri i zgjerimit të Komunitetit Evropian / BE-së. Në këtë mënyrë BE-15 përmes zgjerimeve të lindjes u bë BE-27.

Që prej ndërrimit të regjimit në fund të viteve 80-të në politikën e jashtme çeke është punuar me synim anëtarësimin e suksesshëm në BE. Tani pas përmbushjes së këtij prioriteti të politikës së jashtme objektivi i qeverisë së re çeke është pjesëmarrja aktive dhe konstruktive në aktivitetin politik të ditës në BE. Krahas kësaj qeveria çeke angazhohet edhe për pranimin e një Marrëveshjeje mbi Kushtetutën e Bashkimit Evropian, krejtësisht në kundërshtim me partinë e opozitës ODS, së cilës Ju i përkisni.

ODS dhe integrimi evropian

Partia me tipare të dukshme konservative të djathta, Občanská demokratická strana (ODS, Partia Qytetare Demokratike) u themelua në vitin 1991. Gjatë dy zgjedhjeve të fundit kombëtare ajo u mund nga Socialdemokratët (ČSSD), ndaj në këto shtatë vjet ajo ka qenë partia më fortë opozitare në parlament. Më parë ODS ka qëndruar në pushtet gjatë vjet dhe ka realizuar reforma të thella demokratike dhe ekonomike në vend.

ODS është forca politike më e fuqishme në parlament. Edhe në Dhomën e Dytë politike, në Senatin Çek, ajo është partia me ndikimin më të madh me 37 vota nga gjithsej 81. Sipas numrit të anëtarëve, ODS është partia e tretë më e madhe në Republikën Çeke.

Duke u nisur edhe nga masat jopopullore në sektorin e ekonomisë marrë nga partitë qeveritare çeke, gjatë zgjedhjeve të fundit evropiane në qershor 2004, zgjedhësit i kanë dhënë votën e tyre në pjesën më të madhe sërish ODS. Me 30% të votave kjo parti ka fituar nëntë nga gjithsej 24 mandatet e deputetëve çekë në Parlamentin Evropian.

Qëndrimi i ODS përkundrejt BE-së ka qenë në tërësi më shumë skeptik, në rastin më të mirë asnjënjës. Marrëveshjen mbi Kushtetutën ODS e refuzoi si në Parlamentin Çek ashtu edhe në Senat. Ndërsa përse i përket rritjes së përbashkët të sistemeve ekonomike evropiane ODS ka një qëndrim shumë të hapur. Partia ka sjellë në vëmendje anët problematike deri edhe negative të integritit evropian: tepër burokraci, tepër rregulla, tepër kompetenca Brukselit dhe kufizime kërcënuese të interesave kombëtare çeke. Kushtet e anëtarësimit, negociuar nga qeveria, ODS i ka kritikuar shumë dhe në përgjithësi pozicionin e shteteve të reja anëtare e ka konsideruar si të pafavorshëm. Në më të shumtën e rasteve diskutimet dhe përpjekjet për një thellim të integritit evropian ODS i ka cilësuar si të papërshtatshme.

Bashkëpunimi në fraksionin e PPE-CD është për ODS shumë i vështirë për shkak të qëndrimeve të saj tejet konservative në shumë fusha. Aktualisht ODS është duke shqyrtuar mundësinë e krijimit të një fraksioni të ri të djathtë së bashku me parti të tjera konservative.

Republika Çeke dhe zgjerimi – pozicioni i ODS

Në lidhje me zgjerimin e BE-së me Turqinë dhe shtetet e Ballkanit ODS përfaqëson një mendim të ngjashëm me qëndrimin zyrtar të politikës së jashtme çeke. Edhe në vlerësimin e saj procesi i zgjerimit duhet të vijohet në përputhje me Kriteret e Kopenhagenit. Por brenda partisë ekziston edhe një grupim i mbështetjes së hapur të raundit të ardhshëm të zgjerimit, i cili gjithsesi duhet përgatitur shumë mirë dhe nuk duhet të ketë në asnjë mënyrë ndikim negativ në stadin aktual të integritit ekonomik.

Taktika

Si deputet/e çek/e i/e partisë ODS Ju nuk është se e shikoni me shumë entuziazëm procesin e integritit evropian. Ju vlerësoni në fakt epërsitë e integritit, para së gjithash liberalizimin e tregtisë së jashtme dhe përshtetimin e qarkullimit të mallrave në tregun e brendshëm, por nga ana tjetër përpjekjet Tuaja për thellimin e mëtejshëm të integritit janë shumë të zbehta. Ju refuzoni në mënyrë të përsëritur dhe të paekuivokueshme tendencat për federalizimin e BE-së dhe transferimin e kompetencave të tjera në nivel evropian. Por tërhiqni vëmendjen në lidhje me parimin e subsidiaritetit, ancoruar në marrëveshje, dhe sovranitetit kombëtar dhe larmisë së vendeve anëtare.

Në përgjithësi Ju e mbështesni raundin e ardhshëm të zgjerimit të BE-së, ku fillimisht duhet të trajtohet rasti i Kroacisë. Por në këtë proces Ju insistoni me forcë në një fazë precize përgatitore, e cila rrjedh në mënyrë konsekuente nga përmbushja e Kriteve të Kopenhagenit. Gatishmëria politike dhe ekonomike e secilit vend për të përmbushur kriteret është për Ju me rëndësi vendimtare, në mënyrë që më pas të jepni miratimin Tuaj për kërkesat e anëtarësimit.

Një kandidat ekonomikisht i paqëndrueshëm apo në një gjendje tejet të prapambetur nuk do të kishte për Ju asnjë shans për tu bërë anëtar i Bashkimit Evropian, përse kohë që ai nuk është stabilizuar ekonomikisht dhe nuk arrin të ketë rritje ekonomike. Përndryshe niveli ekonomik i arritur i BE-së aktuale do të kërcënohej.

Një argument i veçantë i Juaj është edhe fakti që subvencionet e fondeve strukturore për gjallërimin e ekonomisë në ndërkohë 12 vendet e reja anëtare (përfshirë këtu edhe Çekinë) nuk janë më të mjaftueshme. Për këtë arsye, por edhe për shkak të mungesës së aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë, Ju angazhoheni fuqishëm për një reformë të shpejtë dhe rrënjësore në Politikën e Përbashkët Agrare dhe për transferimin e një pjese të mirë të mjeteve financiare në fondet e asistencës rajonale.

Ndryshe nga planet për krijimin e sektorëve të rinj të përbashkët politikë apo për realizimin e Projekt-Kushtetutës, në lidhje me çështje të zgjerimit Ju jeni më i hapur. Gjithsesi miratimi Juaj varet nga rezultate të dukshme në procesin e reformave dhe gatishmëria për tu përshtatur e kandidatëve për anëtarësim.

Deputetët/et e PPE-DE nga Gjermania në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

CDU dhe integrimi evropian

Bashkimi Kristian-Demokrat (CDU; www.cdu.de) përfaqësuar me 49 deputetë përbën delegacionin më të madh brenda fraksionit të PPE në Parlamentin Evropian dhe disponon në këtë mënyrë ndikimin më të madh të mundshëm në politikën parlamentare. CDU ka qenë dhe është tradicionalisht një ndër mbështetësit dhe përkrahësit më të fuqishëm të integrimit evropian dhe e ka çuar këtë ide gjithnjë përpara në mënyrë aktive. Aktualisht partia është fokusuar ndër të tjera në politikën e pranimit të të huajve dhe në Politikën e Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë.

Në sektorin e politikës së pranimit të refugjatëve dhe të huajve CDU angazhohet fuqishëm për ruajtjen e kompetencave kombëtare vendimmarrëse. Në vlerësimin e kësaj partie politika për pranimin e të huajve në nivel evropian duhet rregulluar më mirë dhe veçanërisht kufinj të duhen mbrojtur nga migrimi ilegal dhe kontrabanda e kriminalitetit, por kjo gjithsesi nuk duhet të realizohet mbi bazë vendimesh të Këshillit të Bashkimit Evropian, por duhet legjitimuar nga Parlamenti Evropian apo parlamentet kombëtare.

Në Politikën e Jashtme dhe atë të Sigurisë CDU mbështet një mënyrë të përgjegjshme mënzrën e të vepruarit nga BE. Kështu për shembull duhen zgjeruar strukturat ushtarake brenda BE-së, në mënyrë që BE të japë kontribute edhe më të mëdha brenda NATO-s në kuadër misionesh ndërkombëtare. Megjithatë strukturat evropiane të sigurisë nuk duhet të rëndojnë mbi SHBA-të por duhet t'i krijojnë Aleancës transatlantike mundësi më të mëdha veprimi.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian – Pozicioni i CDU

Me anëtarësimin e dhjetë vendeve të reja anëtare nga Evropa Qendrore dhe Lindore si dhe të Maltës dhe Qipros në maj të vitit 2004 dhe të Bullgarisë dhe Rumanisë në janar 2007 Bashkimi Evropian e ka përmbyllur me sukses raundin e pestë të zgjerimit.

Paralelisht me këtë Komisioni Evropian vendosi në plan të parë të politikës së vet përafrimin e Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Detyra qendrore e politikës evropiane të zgjerimit në vitin 2008 konsiston, sipas CDU, në konsolidimin e arritjeve të deritanishme, në moslejimin e kthimit prapa të reformave të iniciuara në vendet kandidate dhe në dhënien e kontributit në kuadër të partneriteteve për anëtarësim si dhe të marrëveshjeve të stabilizim-asociimit në të mirë të zhvillimit ekonomik, të bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë dhe ruajnë perspektivën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit me kandidatët potencialë për anëtarësim nga Ballkani Perëndimor janë një instrument i pajisur me kushte, instrument ky që do t'u mundësojë vendeve që aspirojnë anëtarësimin të përcaktojnë vetë përmes hapave individualë në proceset e reformave, ritmin e përafrimit me Bashkimin Evropian.

Secili prej vendeve kandidate meriton një verifikim individual të pjekurisë së tyre për anëtarësim. Pas anëtarësimit të Bullgarisë dhe Rumanisë, Bashkimi Evropian duhet të

ripranojë anëtarë të rinj, vetëm pasi shtetet e BE-së të ratifikojnë respektivisht të fuqizojnë një marrëveshje të re.

Në kuadër të politikës evropiane të fqinjësisë së mirë Grupi i Punës për Evropën është marrë edhe me gjendjen në Kaukaz dhe hyrjen e trupave ruse në Gjeorgji. Invazioni i Rusisë në zemër të Gjeorgjisë në datat 9 dhe 10 gusht 2008 dhe njohja e pavarësisë së të dy rajoneve nga presidenti rus do të thotë për Grupin e Punës një shkelje e rëndë e të drejtës ndërkombëtare dhe e kufijve territorialë të Gjeorgjisë. Shenja e barazimit që vihet mes këtyre trupave dhe ndërhyrjes së trupave të NATOS-s në Kosovë është e papranueshme, pasi shkëputja e Kosovës nga Serbia ishte pasojë e pezullimit të statusit të autonomisë nga ish-presidenti serb Milloshevic, ndjekur nga shtypja dhe vrasjet etnike si dhe pasojë e faktit, që bisedimet ndërkombëtare për një status autonomie të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara dështuan pikërisht për shkak të Serbisë dhe Rusisë. Rusia deri më sot ka refuzuar të njohë shkëputjen e Kosovës me pretendimin se është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, dhe jo për këtë arsye duhet të justifikojë veprimet e veta ushtarake si paralele me zhvillimet në ish-Jugosllavi dhe njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet perëndimore dhe ato të BE-së.

Fraksioni i CDU përshëndet qëndrimin e qartë të Këshillit Evropian në lidhje me të drejtën e secilit shtet evropian, për të formuar aleanca në mënyrë të pavarur duke respektuar të drejtën ndërkombëtare dhe bashkëpunimin paqësor. Kjo vlen edhe për dëshirën e çdo shteti për t'u bërë anëtar i NATO-s dhe për të kërkuar kështu një lidhje edhe më të ngushtë me Bashkimin Evropian. Por për këtë duhet që vetë vendi në fjalë të krijojë kushtet e duhura, duke plotësuar standartet e demokracisë dhe shtetit ligjor, që priten nga një anëtar i NATO-s.

Taktika

Si përfaqësues i CDU Ju keni një peshë shumë të madhe në Parlamentin Evropian. Por në realizimin e çështjeve Tuaja në lidhje me zgjerimin e BE Ju varenë nga miratimi i fraksioneve të tjera. Përpiquni të fitoni ndikim në qeveritë konservative brenda Këshillit Evropian, që mund të kenë të njëjtin gjykim me Ju.

Referuar një anëtarësimi të mundshëm të Turqisë idetë Tuaja janë shumë të qarta. Për momentin Turqia nuk mund të bëhet anëtar me të drejta të plota i BE-së. Edhe nëse procesi i reformave në Turqi ka nisur tashmë, vendi është ende shumë larg standardeve evropiane (të drejtat e njeriut, demokracia, shteti ligjor, liria e fesë dhe e shtypit). Madje anëtarësimi i plotë i Turqisë në parim është një opsion i përjashtuar, duke qenë se në pikëpamje të historisë së kulturës dhe mentalitetit ajo nuk është pjesë e Evropës. Pas zgjerimit dhe rritjes së BE-së me pothuaj 30 shtete anëtare nuk mund të përballet anëtarësimi i Turqisë. BE nuk do të ketë më aftësi operative dhe do të ishte e tejngarkuar edhe nga pikëpamja ekonomike.

Ju, në thelb, përshëndesni të gjitha kërkesat për anëtarësim nga ana e shteteve të Ballkanit, por bëni të qartë një gjë: për momentin e anëtarësimit vendimtare nuk është shpejtësia por cilësia e reformave në vendet, që aspirojnë anëtarësimin. Si kusht paraprak për pranime të reja, për Ju, është përfundimi i reformave të brendshme në BE në nivel institucional, financiar, atë të politikës agrare dhe të fondeve strukturore. Shtetet që synojnë anëtarësimin duhet të liberalizojnë strukturat e tyre ekonomike dhe të kenë arritur një nivel të caktuar të aftësisë së tyre konkurruese për dinamikën e konsiderueshme të tregut të brendshëm evropian.

Ju angazhoheni për një Evropë të fuqishme dhe funksionale, e cila nuk duhet parë si kontra-projekti i SHBA-ve, por që së bashku me SHBA-të përball sfidat ndërkombëtare.

Deputetet/ët e PPE-DE nga Spanja në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Partia Popullore e Spanjës dhe integrimi evropian

Spanja është bërë anëtare e Komunitetit Evropian që prej vitit 1986 dhe që prej asaj kohe ka përjetuar një hov ekonomik të fuqishëm. Në të vërtetë ka ende rajone të prapambetuara nga ana ekonomike, si për shembull Estremadura (Spanja qendrore), por Spanja, në sajë të niveleve të ulëta të pagës, është shndërruar në një vend të rëndësishëm prodhues për Evropën.

Përmes zgjerimit të Bashkimit Evropian drejt veriut, realizuar në vitin 1995 me Austrinë, Suedinë dhe Finlandën, u reduktua ndikimi i shteteve anëtare të jugut brenda Bashkimit Evropian nën udhëheqjen e spanjollëve dhe italianëve. Qeveria dhe popullsia spanjolle druajnë që Spanja së bashku me shtetet e tjera „të vjetra“ evropiane të Mesdheut do të shtrëngohet të shkojë në periferi të Bashkimit Evropian përmes zgjerimeve në drejtim të lindjes në vitet 2004 dhe 2007 dhe zgjerimeve të tjera të planifikuara, dhe kjo jo vetëm gjeografikisht por edhe politikisht. Kjo do të ishte në kundërshtim me vetëkonceptimin e Spanjës, që e konsideron veten si anëtare të „bërthamës së Evropës“. Për këto motive modeli i shteteve anëtare që bashkëpunojnë me njëri tjetrin në nivele të ndryshme intensiteti refuzohet prej tyre. Integrimi duhet përforcuar në nivel të njësuar.

Si shtet periferik i rajonit të Mesdheut Spanja e konsideron një detyrë të rëndësishme përforcimin e politikës evropiane të Mesdheut. Kështu për shembull duhet konsoliduar mbështetja financiare e rajonit dhe bashkëpunimi ekonomik si dhe duhet intensifikuar dialogu politik dhe ekonomik me shtetet e Lindjes së Afërt. Spanja i vlerëson problemet në rritje me të ashtuquajturin rajon jugor të BE-së (p.sh. presioni i emigrimit nga Afrika e Jugut, fundamentalizmi islamik) si shumë më rënduese për interesat e veta kombëtare se sa çështja e zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Megjithë humbjet financiare, që zgjerimi i BE-së në drejtim të lindjes mbart mbi vete, Spanja e ka mbështetur këtë hap dhe ka qenë në thelb pozitive përkundrejt anëtarësimeve të tjera në BE. Edhe sipas pikëpamjes së partisë kristiano-konservative Partido Popular (Partia Popullore) pranimi i shteteve të reja anëtare në BE duhet vlerësuar pozitivisht.

Partia Popullore në vitet nëntëdhjetë ka lëvizur në drejtim të qendrës së spektrit politik dhe është tanimë një parti e qendrës së djathtë. Ajo angazhohet për një Evropë të bashkuar dhe demokratike, vlerat bazë të së cilës janë liria, demokracia dhe humanizmi si dhe përfaqëson një profil të fuqishëm ekonomik. Për këtë parti janë të rëndësishme edhe temat e sigurisë dhe të luftës kundër terrorizmit. Partido Popular ka formuar qeverinë deri në vitin 2004, prej së cilës doli në zgjedhjet parlamentare të atij viti nga Partia Socialiste Partido Socialista Obrero Español (PSOE). Në vitin 2008 ajo i humbi sërish zgjedhjet parlamentare në Spanjë.

Prej vitit 1989 Partido Popular është anëtare e PPE (Partisë Popullore Evropiane) dhe ka 24 nga 54 deputetët spanjollë.

PP dhe raundi tjetër i zgjerimit

Partido Popular është sigurisht për një Evropë më të madhe dhe të integruar dhe mbështet zgjerimin e BE-së. Por ky zgjerim nuk duhet të realizohet në dëm të thellimit. BE-ja konsiderohet nga Partido Popular si një bashkim shtetesh sovraane, i cili bazohet mbi të drejtat themelore dhe demokracinë. Në këtë mënyrë Evropa përfaqëson një komunitet vlerash politike, intelektuale dhe kulturore. Për këtë arsye Partido Popular është deklaruar gjithmonë për anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë në BE si dhe mbështet edhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian. Ndërsa kundrejt anëtarësimin të Turqisë Partido Popular është shumë kritike, pasi ky vend sipas partisë nuk mbështetet në vlerat e përbashkëta bazë të BE-së.

Më shqetësim të madh PP ndjek zhvillimet në lidhje me çështjen e pavarësisë së Kosovës. Në ndryshim nga Gjermania apo Franca, Spanja nuk e ka mbështetur për asnjë moment shkëputjen e Kosovës nga Federata Jugosllave dhe së bashku me Greqinë, Qipron, Rumaninë dhe Sllovakinë nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në të njëjtën kohë këto vende mbështesin misionin EULEX të BE-së në Kosovë, i cili ka për qëllim ndërtimin e shtetit ligjor në Kosovë. Shqetësimi që përmes njohjes së pavarësisë së Kosovës do t'u duhet të përballen me kërkesat separatiste në vend është dominues, ndaj edhe Spanja kërkon shprehimisht përforsimin e Serbisë.

Taktika

Si deputet/e i/e PP, në parim, Ju e mbështesni zgjerimin e Bashkimit Evropian. Por theksoni – në fraksionin Tuaj dhe në Komision – që një union i bashkuar nuk duhet të jetë një union më i dobët. Vetëm pasi vendet kandidate të kenë arritur në mënyrë të përafërt standardet ekonomike të BE-së, zgjerimi do të mund të sjellë edhe thellimin. Si fillim këtë kusht e plotëson vetëm Kroacia.

Për sa kohë që jo të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur, anëtarësimi në Bashkimin Evropian në gjykimin Tuaj do të ishte i pamundur. Edhe nëse Ju nuk mund të deklarojeni hapur në lidhje me këtë, në kuadër të misioneve të BE-së Ju e ndihmoni Kosovën në ndërtiminin e pavarësisë së vet.

Mëshojini një afati të gjatë tranzicioni në lidhje me lëvizjen e lirë të emigrantëve për qëllime punësimi, hapjen e tregut bujqësor të Komunitetit dhe pranimit të shteteve të reja anëtare në projektet e BE-së për përforsimin e strukturave në rajon, në mënyrë që të fitoni miratimin e popullsisë për zgjerimin. Me këtë kërkesë Ju mund të shmangni që fondet për vendin Tuaj të shkurtohen ndjeshëm në kuadër të një faze të re zgjerimi.

Turqinë e konsideroni si një partner të rëndësishëm në pikëpamje ekonomike dhe strategjike. Me idenë e anëtarësimin të Turqisë në Bashkimin Evropian, i cili ka në bazë të tij vlerat kristiane, e keni të vështirë të ambjentoheni. Shprehni rezervat Tuaja në mënyrë diplomatike.

Deputet/e e PPE/ED në Komisionin e Jashtëm të PE nga Franca

Union pour un mouvement populaire (UMP) dhe integrimi evropian

UMP (Bashkimi për Lëvizjen Popullore) është një bashkim partish të ndryshme konservative – ndër të tjera edhe Rassemblement pour la République (RPR) – dalë nga zgjedhjet presidenciale dhe që atëherë është etabluar në Francë si parti. Në përgjithësi kjo parti bën një politikë proevropiane, e cila synon një rol të përshtatshëm të Francës në një Evropë të bashkuar. Procesi i zhvillimit të Evropës si një e tërë në fillim të shek. XXI shihet si diçka e domosdoshme për modernizimin e Francës dhe për një pavarësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Mbizotëron bindja, sipas së cilës madhësia e kombit francez mund të ruhet vetëm në një Evropë të bashkuar e të pavarur, e cila të ketë strukturën e një federate shtetesh kombëtare dhe respekton të qenët ndryshe të anëtarëve të vet të veçantë.

Për UMP është veçanërisht e rëndësishme jo vetëm të ndërtohet një zonë ekonomike evropiane, por edhe të realizohet një union politik me vlera të qarta themelore, me identitetin e vet dhe me objektiva të caktuara politike dhe sociale. Një Bashkim Evropian i tillë duhet të jetë në gjendje të krijojë një barazpeshë të pavarur të SHBA në politikën botërore. Për këtë nevojitet edhe krijimi i një politike evropiane të mbrojtjes, e cila të mund të garantojë paqen në kontinentin evropian. Në këtë kontekst kjo parti angazhohet fuqishëm për ratifikimin e Kushtetutës Evropiane.

UMP dhe zgjerimi i ardhshëm

Ashtu si edhe një pjesë e madhe e popullsisë franceze edhe Union pour un mouvement populaire i ka përshëndetur dhe mbështetur raundet e fundit të zgjerimit si fund të ndarjes së Evropës dhe realizim të vlerave të paqes, demokracisë dhe solidaritetit. Zgjerimi në drejtim të Lindjes ka qenë pra një pjesë përbërëse e logjikës gjeografike dhe historike të kontinentit dhe njëkohësisht edhe një sfidë historike. Krahas forcës së një simboli politik dhe historik kjo parti i vë theksin edhe efektit pozitiv ekonomik mbi situatën e punësimit dhe rritjes ekonomike në Evropë. Por UMP sjell në vëmendje edhe faktin që Franca duhet të rrisë atraktivitetin e vet ekonomik, nëse nuk do të bëjë hapa mbrapa në këtë Evropë të re.

Anëtarët e UMP janë prej vitesh të mendimit që BE aktuale i ka arritur tanimë kufijtë e vet natyralë, ndaj edhe tema e zgjerimit për ta nuk ka më rëndësi. Vëmendjen kryesore kjo parti e ka përqendruar tanimë në ruajtjen dhe përforcimin e mëtejshëm të karakterit të BE si një komunitet politik, të bazuar në vlera dhe me aftësi për të vepruar. Për këtë është absolutisht e nevojshme që Unioni t'i përcaktojë qartë kufijtë e vet. Përndryshe një BE, që zgjerohet pafundësisht do të degjeneronte në një zonë të tregtisë së lirë dhe aq, një zhvillim ky të cilit koncepti francez për një Union politik dhe para së gjithash social i kundërvihet në mënyrë diametralisht të kundërt. Për pasojë deputetët e UMP kërkojnë përcaktimin përfundimtar të kufijve të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të mund të realizohet një politikë e përbashkët veçanërisht në sektorët e mbrojtjes, politikës së jashtme dhe sigurisë sociale. Gjatë këtij procesi vetëpërcaktimi një faktor vendimtar për të patur një komunitet funksional është trashëgimia e përbashkët historike dhe kulturore.

Duke patur në konsideratë këtë analizë, gjithsesi UMP mbështet anëtarësimin e Kroacisë dhe shteteve të tjera të Ballkanit sapo këto të fundit të kenë realizuar hapat e nevojshëm

të reformave. Për të ruajtur aftësinë operacionale dhe karakterin e veçantë të BE, prej këtyre vendeve duhet të kërkohej marrja përsipër në masë të plotë e *acquis communautaire*, pra të gjithë inventarit juridik të BE, përpara se të realizohet anëtarësimi përkatës.

Por përtej këtyre kufijve për UMP zgjerimi është i paimagjinueshëm. Pasi në rast të kundërt BE nuk do të ishte më BE, por thjesht një shumë interesash të veçanta, një strukturë demokratike e pamenduar mirë dhe një zonë ekonomike pa një vullnet të përbashkët dhe pa asnjë lloj ndikimi. Që kjo të mos ndodhë, UMP përkrah idenë e dhënies fund procesit të zgjerimit pas pranimit të shteteve të sipërpërmendura.

Vetëkuptohet që kjo nuk do të thotë, që Evropa pas kësaj do të mbyllet pas kufijve të shtrënguar kundrejt pjesës tjetër të botës. Për ata vende që nuk do t'i përkasin BE, partia dëshiron të zhvillojë programe për partneritete dhe bashkëpunim intensiv.

Taktika

Si deputet i UMP duke ndjekur logjikën e argumentimit të mësipërm objektivi Juaj kryesor është të pengoni anëtarësimin e Turqisë në BE. Mbështetuni në analizën e sipërme dhe bëni të qartë që Ju nuk vendosni kundër Turqisë, por pro BE dhe në mënyrë të veçantë pro idesë së Evropës. Ju e vlerësoni këtë vend si një mik dhe komb të madh, po kështu edhe progresin e konsiderueshëm që ai ka bërë në drejtim të demokracisë dhe shtetit ligjor. Për të mbështetur më tej këtë proces si dhe për të zgjeruar bashkëpunimin dypalësh Ju propozoni lidhjen e ngushtë të Turqisë me BE në një raport të privilegjuar partneriteti.

Një anëtarësim me të drejta të plota do ta dobësonte ndjeshëm aftësinë operative dhe karakterin immanent të Bashkimit Evropian. Në një komunitet prej kaq shumë zërash nuk do të mund të realizoheshin as një union i vërtetë politik dhe social dhe as një emancipim ndërkombëtar i SHBA. Parashtroni argumentin që këtu nuk është fjala për besimet fetare, por për çështjen e ruajtjes së një BE politike në origjinalitetin dhe finalitetin e vet. Për Ju anëtarësimi i Turqisë do të ishte arratisje nga përkufizimi i nevojshëm gjeografik i Evropës. Pasi, nëse hyn Turqia, nuk do të kishte më argumenta të bazuar kundër anëtarësimit të vendeve të tilla si Ukraina, Moldavia, Bjellorusia apo shteteve të Maghreb-it (Tunizia, Algjeria e Veriut, Maroku...), gjë që do të thoshte një zgjerim pafund i BE pa kufij të përcaktuar qartë.

Edhe përkundrejt Turqisë Ju argumentoni, që një „Jo!“ e qartë është më e ndershme se një „Ndoshta dikur“. Veç kësaj Ju tërhiqni vëmenden në lidhje me qëndrimin tejet skeptik të popullsisë evropiane dhe veçanërisht asaj franceze në lidhje me anëtarësimin e Turqisë dhe paralajmëroni, se po luhet me frikën dhe pasigurinë e popujve.

Përpiquni që brenda fraksionit Tuaj të mund të gjeni mbështetje për pozicionin Tuaj, një partner i mundshëm do të ishte për shembull partia simotër gjermane CDU-CSU. Sado të jeni i bindur për linjën e mësipërme, në strategjinë Tuaj të argumentimit dhe në përzgjedhjen e fjalëve duhet të mbani në konsideratë faktin, që kryetari i shtetit francez, që është edhe anëtar i partisë Suaj, i ka sinjalizuar Turqisë në mënyrë të kujdesshme një perspektivë afatgjatë anëtarësimi. Këto mospërputhje brenda partisë Suaj duhet t'i keni gjithmonë parasysh. Ndaj i mëshoni faktit, që Ju kërkonit të keni me Turqinë një partneritet të ngushtë të privilegjuar, që do të mundësonte një fqinjësi të mirë jashtë anëtarësisë së plotë.

Edhe ndaj anëtarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor Ju jeni kritik. Deri në një farë mase mund të pranoni hyrjen e Kroacisë, dhe këtë jo vetëm për arsyen që të mos akuzoheni, se po bllokoni procesin. Por edhe këtu apeloni për vetëpërmbytje dhe sillni në vëmendje respektimin strikt të Kriteve të Kopenhagës.

Deputetët/et e EVP-ED nga Italia në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Italia dhe integrimi evropian – Pozicioni i Forza Italia

Italia është një ndër palët nënshkruese të Traktatave të Romës të vitit 1957, anëtare e NATO-s dhe e Unionit Evropiano-Perëndimor. Që në fillim Italia ka qenë shumë e bindur në lidhje me idenë e Komunitetit Evropian dhe ka bërë një politikë të orientuar qartë drejt Evropës. Edhe sot Italia është një ndër shtetet anëtare të BE-së ndër më pozitivet për çështjen e integritimit.

Për shkak të pozicionit të saj gjeografik politika e rajonit mesdhetar është e një rëndësie të madhe për Italinë. Për këtë arsye ajo ka mbështetur zgjerimin e BE-së në drejtim të Jugut (pranimi i Greqisë, Spanjës, Portugalisë, Bullgarisë dhe Rumanisë), edhe pse me këto pesë vende Italia ka raporte konkurrence në lidhje me tregun agrar të jugut.

Zgjerimi i BE-së në drejtim të Lindjes, kundrejt të cilit Italia ka mbajtur parimisht një qëndrim pozitiv, është marrë në konsideratë para së gjithash nga pikëpamje financiare dhe të politikave të sigurisë. Italia stepet disi, pasi përmes anëtarësimit të këtyre shteteve mund të kishte humbje financiare dhe një ndikim më të paktë brenda BE-së. Por duke qenë se Italia ndjek në mënyrë të veçantë interesat e saj pranë Detit Mesdhe çështja e anëtarësimit të Maltës dhe Qipros ishte me interes më të madh se ajo e anëtarësimit të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

E megjithë këto rezerva zgjerimin e mbështeti edhe partia e djathtë konservatore Forza Italia („Përpara Italia“). Forza Italia u themelua në vitin 1994 nga Silvio Berlusconi si një lëvizje e re politike pas shpërbërjes së "Democrazia Cristiana". Ajo angazhohet kryesisht për një Itali liberale dhe më pak të centralizuar. Me angazhimin e tyre pjesërisht populist për një Itali patriotike, që në të njëjtën kohë është e hapur për komunitetin dhe solidaritetin në Evropë, kjo parti u zgjodh si në parlamentin italian ashtu edhe në atë evropian. Në Parlamentin Evropian ajo përfaqësohet me 24 vende nga gjithsej 78 deputetë italianë.

Mbi Forza Italia-n ka diskutime të shumta para së gjithash për shkak të Berlusconi-t dhe premtimeve të tij elektorale. Kryetari i partisë është gjendur disa herë përpara gjykatave me akuzat për korrupsion, financime ilegale të partisë, falsifikime të bilancit dhe është dënuar tre herë me heqje lirie në Shkallën e Parë. Por deri më tani nga gjykatat italiane nuk është përmbaarur ende një dënim ligjor i formës së prerë me heqje lirie.

Qeveria e udhëhequr që prej vitit 2001 nga Silvio Berlusconi dhe Forza Italia dëshmoi të jetë qeveria më e qëndrueshme në historinë e Italisë së pasluftës. Nga pikëpamja politike ajo ra herë pas here në presion dhe nuk mundi të realizonte projekte të ndryshme ndër të tjera edhe për shkak të protestave masive të sindikatave dhe pjesërisht të rezistencës së partnerëve në koalicion. Në heqjen e kësaj partie nga pushteti një rol të rëndësishëm luajti gjendja konjunkturale e vendit. Partia, përkundër premtimeve të veta elektorale, nuk ia kishte dalë të inicioje një fazë lulëzimi ekonomik. Përkundrazi vendi shënoi ritme të ulëta të rritjes ekonomike dhe një deficit të lartë buxhetor.

Pas humbjes së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006 kundër ish-Presidentit të Komisionit Evropian Romano Prodi, Forza Italia mundi të vinte sërish në pushtet në vitin 2008.

Forza Italia dhe zgjerimi i Bashkimit Evropian

Italia ka mbështetur që prej fillimeve të Bashkimit Evropian të gjitha masat që synojnë thellimin e komunitetit. Në këtë kuptim të gjitha zgjerimet e deritanishme janë vlerësuar si zhvillime pozitive. Forza Italia është pozitive edhe në lidhje me zgjerimin e planifikuar, por ka megjithatë rezerva në lidhje si me avantazhet politike ashtu edhe disavantazhet e mundshme ekonomike. Demokratizimi dhe stabilizimi i Evropës Qendrore dhe Lindore është në fakt një objektiv i rëndësishëm për Italinë, i cili nuk duhet realizuar në kurriz të politikës evropiane mesdhetare.

Në lidhje me pranimin e Turqisë në Bashkimin Evropian Forza Italia shprehet pozitivisht por distancohet nga pozicioni i PEP (Partisë Popullore Evropiane), së cilës i përket Forza Italia në Parlamentin Evropian.

Taktika

Ju mbështesni objektivin e zgjerimit të Bashkimit Evropian, me qëllim realizimin e frymës së vërtetë të Traktateve të Romës – krijimin e një komuniteti të madh evropian. Natyrisht vendet kandidate duhet të përmbushin për këtë kushte të caktuara politike dhe ekonomike, përpara se të mundësohet anëtarësimi në Bashkimin Evropian. Por BE duhet t'i mbështesë gjerësisht vendet kandidate në përpjekjet e tyre për reforma, pa reduktuar asistencën për zonat me struktura të dobëta të vendeve aktualisht anëtare të saj dhe, para së gjithash, të Italisë.

Megjithëse jeni dakord me zgjerimin për Ju është e rëndësishme gjithashtu, që përmes zgjerimit në drejtim të Juglindjes të mos dëmtohet politika e fqinjësisë së mirë në rajonin e Mesdheut. Për Ju ka shumë rëndësi bashkëpunimi i ngushtë me këto vende fqinje, në mënyrë që të zgjidhen probleme të tilla si migrimi ilegal në drejtim të Evropës dhe lufta kundër fundamentalizmit dhe terrorizmit islamik. Për shkak të shtrirjes Suaj gjeografike Ju prekeni ndjeshëm nga të dy problematikat.

Jeni i vetëdijshëm, që zëri Juaj si pjesëtar i fraksionit më të fuqishëm në Parlamentin Evropian ka peshë. Ndaj përpiquni që brenda për brenda fraksionit të arrini njësimin në lidhje me pozicione të rëndësishme të politikave të zgjerimit. Paraqisni gjatë këtyre konsultimeve domosdoshmërinë e një zgjerimi të shpejtë edhe duke marrë në konsideratë Turqinë. Në vlerësimin Tuaj pranimi i Turqisë do të krijojë një hapësirë më të madhe stabiliteti dhe demokracie, nga e cila në fund të fundit do të përfitojnë të gjitha palët. Pa e thënë hapur Ju gjithsesi jeni i mendimit, që anëtarësimi i Turqisë do të përforconte pozicionin dhe përfaqësimin e interesave të shteteve anëtare të Evropës së Jugut brenda BE-së.

Një lidhje të fortë Italia ka edhe me Shqipërinë – kjo edhe për arsye historike. Në kuadër të angazhimit për Ballkanin sipas këndvështrimit italian rritet edhe roli i Shqipërisë. Për më tej Forza Italia nisur nga motive historike, dhe në këtë kontekst edhe nga valët e refugjatëve në drejtim të Italisë, dëshiron një përfshirje të shpejtë të Shqipërisë në bisedimet për anëtarësim.

Fraksioni i „Partisë Social-Demokrate të Evropës" në Parlamentin Evropian (PSE)

www.eurosocialists.org

Fraksioni i Partisë Social-Demokrate të Evropës është krijuar në vitin 1992 nga Lidhja e Partive Socialiste dhe Socialdemokrate të Komunitetit Evropian. Me pothuaj një të tretën e deputetëve ky fraksion është i dyti për nga madhësia në Parlamentin Evropian dhe përfaqëson parlamentarët socialistë dhe social-demokratë nga të gjitha vendet evropiane. Tradicionalisht rrënjët e veta ky fraksion i ka në luftën e punëtorëve për kushte më të mira pune dhe për një ndarje më të drejtë të mirëqenies. Deputetët angazhohen në mënyrë të veçantë për të drejtat e punëmarrësve, mbrotjen dhe respektimin më të madh të të drejtave të njeriut dhe qytetarit, mbështetjen e paqes dhe të bashkëpunimit të një Evropë pa kufinj si dhe për mbrotjen e konsumatorit.

Për deputetët e PSE Evropa është një rend ndërshtetëror që sjell më shumë barazi sociale, demokraci në shtet dhe ekonomi, si dhe më tepër solidaritet mes popujve të mbarë botës – para së gjithash me ata të Botës së Tretë. PSE është për zgjerimin e BE-së, që do të sillte përforcimin e demokracisë por në të njëjtën kohë do të ruante larminë kulturore të popujve. Për këtë fraksion BE është një instrument për t'iu përgjigjur sfidave, që shtete të veçanta kombëtare nuk mund t'i përballojnë më vete. Këtu bëjnë pjesë globalizimi i ekonomisë por edhe terrorizmi dhe varfëria. Një objektiv aktual i rëndësishëm brenda PSE është krijimi i vendeve të punës dhe zhvillimi i një modeli social evropian. Ky fraksion kërkon një strategji të koordinuar të rritjes ekonomike, dhe krahas kësaj duhet të ketë një diskutim më intensiv të çështjeve sociale në tregun e brendshëm. Roli i Parlamentit – si institucioni i vetëm vërtetë demokratik i zgjedhur nga populli – duhet të fuqizohet më tej.

PSE angazhohet për Politika të Përbashkëta në Punët e Jashtme dhe Cëshjet e Sigurisë, si dhe për një Politikë të Përbashkët në Çështje të Mbrojtjes si hapa të rëndësishme këto drejt garantimit të paqes në një Evropë që rritet e zhvillohet si një e tërë. Zgjerimin e BE-së ky fraksion e sheh si një shans historik për t'i dhënë fund përfundimisht ndarjes së Evropës, për zgjerimin e kufijve gjeografikë dhe mbështetjen e demokracisë dhe stabilitetit në të gjithë kontinentin. PSE mbështet idenë e hapjes së njëkohshme të bisedimeve të anëtarësimit me të gjitha vendet candidate, edhe pse ndonjëri mund të jetë në gjendje të anëtarësohet më herët. Në vlerësimin e PSE vendimtare për anëtarësimin është adaptimi i kuadrit ligjor të BE-së – *acquis communautaire* – , por në të njëjtën kohë për PSE mund të ketë edhe marrëveshje tranzitive. K fraksion do të donte një mbështetje të veçantë nga ana e BE-së për vendet candidate, që kanë ende një rrugë të gjatë përpara deri në anëtarësimin e plotë.

Përsa i përket Turqisë PSE thekson se është parimisht e hapur dhe evidenton mundësinë parimore të anëtarësimit, të parashikuar që me Marrëveshjen e Asociimit të vitit 1963. Por përpara se të fillojnë bisedimet e anëtarësimit, fraksioni kërkon prej Turqisë respektimin e „kriterëve politike" të anëtarësimit: krijimin e një demokracie solide, respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, vendosjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë sipas parimeve të të drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Fraksioni konsideron të nevojshme reforma rrënjësore ekonomike dhe politike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojnë të punojnë për përmbushjen e Kriterëve të Kopenhagenit, ku presupozohet ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale, stabiliteti ekonomik, respektimi i të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi me vendet fqinje. Në një hap të parë fraksioni i PSE do të kërkonte heqjen e vizave për qytetarët e vendeve të Ballkanit.

Bashkëpunimi i plotë me Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës vazhdon të mbetet një kusht qendror për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin në BE.

Sipas Fraksionit të PSE progresi i shënuar nga Kroacia dërgon një sinjal pozitiv drejt vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor në lidhje me perspektivën e tyre për anëtarësim, sapo ata të kenë përmbushur kushtet e nevojshme.

Veçanërisht bashkëpunimi mes Parlamentit Evropian dhe parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor është një faktor vendimtar në përgatitjet e këtyre vendeve për pranimin e tyre në BE.

Detyra Juaj si anëtar i fraksionit

Perfytyroni se jeni anëtar i fraksionit. Për realizimin e interesave Tuaja Ju nevojitet mbështetja e grupeve të tjera politike, dhe për Ju është tejet e rëndësishme të bëheni të vetëdijshëm që veçanërisht Partia Popullore Evropiane dhe Fraksioni i Partive Socialdemokrate të Evropës luajnë role të rëndësishme në Parlamentin Evropian dhe që në raste të caktuara mund të bllokojnë iniciativat Tuaja, nëse gjen Partnerë më të „vegjël“ koalicioni.

Kështu varet nga Ju të gjeni të mesmen e duhur. Pasi nga njëra anë Ju duhet të kërkonti kompromisin – që mund të çojnë në detyrën e profilit politik – dhe nga ana tjetër fiksimi në pozicionet Tuaja mund të çojë në një dobësim të ndikimit të Parlamentit Evropian, nëse Ju nuk mund të gjeni gjuhën e përbashkët me kolegët Tuaj. Kjo do ta çonte marrjen e vendimit në duart Komisionit dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian

Në çdo fraksion ka ekspertë të veçantë për fusha të caktuara politike. Ju bëni pjesë në „Komisionin për Punët e Jashtme“ dhe punoni kryesisht për çështje të strukturimit të ardhshëm të një Bashkimi Evropian në shndërrim dhe zgjerim. Është në dorën Tuaj të kuptoni dhe analizoni mundësitë dhe rreziqet e zgjerimit. Detyra Juaj është të merreni vesh me anëtarët e tjerë të Komisionit për të përfaqësuar një pozicion të përbashkët në lidhje me çështjen e zgjerimit. Më pas do të nisni të kërkonti mbështetës nga fraksionet e tjera, të krijoni koalicione dhe të diskutoni rreth kësaj tematike në mënyrë kontroverze në parlament, në mënyrë që të arrini të bindni kundërshtarët Tuaj politikë për bindjet Tuaja politike. Por jini të vetëdijshëm: Nuk ka kuptim të flisni pa dëgjuar. Në mënyrë që puna e Parlamentit Evropian të jetë efektive duhet të punoni për të arritur një kompromis, me qëllim që të mund të keni sukses edhe në propozimet e Këshillit të BE-së, edhe nëse ato eventualisht nuk përputhen me linjën e Parlamentit Evropian.

Deputetët/et e SPE nga Austria në Komisionin për Punët e Jashtme në Parlamentin Evropian

Austria në BE – pozicioni i SPÖ

Për shkak të Ligjit të Neutralitetit të vitit 1955 Austria ka qenë për një kohë të gjatë skeptike përkundrejt anëtarësimit në BE. Por megjithatë, pas lëkundjes së kursit politik, edhe Austria u bë anëtare e BE-së (1955), gjë që u mbështet nga shumica e popullsisë austriake.

Që në fillim të anëtarësisë së saj Austria sinjalizoi dëshirën e saj për të bërë pjesë në qendrën e fortë të Bashkimit Evropian. Kështu për shembull ajo nënshkroi Marrëveshjen Schengen, me anë të së cilës rregullohej heqja graduale e kontrollit të personave në kufinj të brendshëm të shteteve nënshkruese. Megjithë neutralitetin e politikës së saj të jashtme, Austria ka dhënë dhe jep kontributin e saj në Politikën e Përbashkët të Unionit për Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë.

SPÖ ka qenë për shumë vite pjesë e qeverisë dhe në momentin kur Austria u bë anëtare e BE-së, kjo parti kishte postin e Kancelarit. Në politikën e tyre për Evropën Socialdemokratët austriakë përqendrohen para së gjithash në tre fusha:

- zhvillimi i mëtejshëm i BE-së në një Union Social dhe Punësimi,
- reformimi i institucioneve evropiane me objektiv urgjent, pengimin e keqformacioneve ekonomike, korrupsionit dhe mashtrimit,
- zhvillimi i një arkitekture evropiane për sigurinë duke ruajtur neutralitetin austriak.

SPÖ dhe faza tjetër e zgjerimit

SPÖ e ka mbështetur raundin e fundit të zgjerimit me dhjetë shtete të tjera të Evropës nisur vecanërisht nga arsye ekonomike dhe të politikave të sigurisë. Për shkak të shtrirjes së saj periferike në drejtim të Lindjes në Austri ka interes të madh për integrimin në BE të shteteve të tjera evropiano-lindore. Austria përfiton nga shndërrimet politike dhe ekonomike të këtyre vendeve – sikurse të gjitha shtetet e tjera kufizuese. Tregtia e saj me shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore është në rritje të vazhdueshme. Krahas kësaj vendi ka një interes të veçantë në ndalimin e konflikteve të ngjashme si ai në Jugosllavi apo në luftën kundër emigracionit ilegal ekonomik.

Pas përfundimit të fazës së parë të zgjerimit në drejtim të lindjes SPÖ është fillimisht për një fazë konsolidimi, gjatë së cilës do të realizohet i plotë integrimi i shteteve anëtare aktuale dhe do t'i vihet theksi ndërtimit të një Evrope sociale. Këtu luan rol edhe gjendja e zgjedhësve, duke qenë se këta gjithnjë e më tepër po artikulojnë frikën e tyre rreth pasojave të zgjerimit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë tregut të punës.

Pranimin e Bullgarisë dhe Rumanisë SPÖ e mbështeti duke rekomandur gjithë „kujdesin e mundshëm“.

Avantazhet e anëtarësimit të Austrisë në BE janë gjithsesi të padiskutueshme. BE-ja është nga njëra anë projekti më i suksesshëm i paqes në botë, dhe nga ana tjetër Austria ka mundur të përfitojë jashtëzakonisht shumë ekonomikisht nga anëtarësimi në BE. E megjithatë ka nevojë edhe për përmirësime. Çështja më e ngutshme e SPÖ është zhvillimi i BE-së si një bashkim social. Në të ardhmen do të jenë në axhendë jo vetëm ineteresat

ekonomike, por një vlerë po kaq të rëndësishme duhet t'u atribuohet edhe barazisë së mundësive dhe raporteve „fairness“. Gjithashtu me rëndësi esenciale është edhe zgjerimi i komponentit ekologjik të BE-së. Në kohët e shndërrimit klimaterik mbrojtja e mjedisit në Evropë nuk duhet kurrsesi të jetë e mangët.

Kërkesat e SPÖ për vitin 2009 konsistojnë si më poshtë:

- Pohim i hapur të Austrisë për përkatësinë e saj në projektin e paqes BE dhe për anëtarësinë e saj në Bashkimin Evropian
- Një Union Social, një Evropë sociale, që i merr seriozisht problemet dhe interesat faktike të njerëzve që punojnë në BE
- Angazhim i lartë i BE-së si vend asnjnjës dhe partner aktiv në një Evropë të Bashkuar
- Nevojë për më shumë demokraci, përfshirje më të fuqishme të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes evropiane, në mënyrë që të luftohet skepticizmi kundrejt BE-së.
- Ndaj ndryshimet e ardhshme të strukturave të marrëveshjeve me BE-në duhen bërë me referendum popullor, nëse preken interesa parimore të Austrisë. Kjo vlen si për një marrëveshje të re reformash ashtu edhe për ndryshime thelbësore të marrëveshjes aktuale evropiane.
- Qëndrim pozitiv në lidhje me pranimin e Kroacisë në BE dhe me perspektivën e qartë të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor
- Vlerësim skeptik në lidhje me anëtarësimin e Turqisë, kusht themelor për pranimin në këtë rast është rezultati pozitiv i një referendumi popullor

Faktin që SPÖ po ndjek rrugën e duhur në lidhje me politikën e saj evropiane e tregon edhe një anketim i korrikut 2008: 67 për qind u deklaruan pro referendumi popullor për ndryshimet e ardhshme të marrëveshjes dhe për pranimet e anëtarëve të rinj në BE, vetëm 22 për qind e të pyeturve ishin kundër referendumeve popullore.

Taktika:

Ju si deputet/e i SPÖ në Parlamentin Evropian mbështesni linjën e sapoprezantuar të partisë në lidhje me zgjerimin dhe formësimin e Unionit, ku, me bindjet Tuaja, duhet të plotësoni pasaktësitë dhe vendet gri në programatikën e partive. Edhe për shkak të të shkuarës shumëkombëtare austriake, në parim, Ju e mbështesni integrimin dhe jeni shumë i interesuar për një shkëmbim të përforcuar politik, ekonomik dhe kulturor me shtetet që aspirojnë anëtarësimin. Rrezikun e një popullariteti të munguar në elektoratin Tuaj lidhur me çështjen e zgjerimit Ju e përballoni duke shpjeguar dhe qartësuar motivet dhe avantazhet e zgjerimit për Austrinë. Gjithsesi, sipas mendimit Tuaj, anëtarësimet e reja në BE nuk duhen bërë as pa kushte dhe as nxitimthi.

Për t'u paraprirë rezervave të zgjedhësve/zgjedhëseve Tuaj/a në lidhje me çështje të zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe ndryshime të marrëveshjeve bazë (si Traktati i Nisës apo ai i Lisbonës) Ju kërkoni, në thelb, referendume popullore. Kërkesa Juaj gjithsesi nuk mbështetet nga fraksionet e tjera të Austrisë.

Në përgjithësi për Ju është e rëndësishme që diskutimi i rihapur për zgjerimin as të mbivendoset dhe as të pengojë zhvillimin dhe integrimin në progres të vetë BE-së. Për këtë arsye Ju mbështesni idenë e një ndërprerjeje (të shkurtër?) konstruktive në procesin e zgjerimit si dhe idenë e përqendrimit dhe konsolidimit të gjitçkaje të arritur. Për Ju është i rëndësishëm para së gjithash zgjerimi i komponentit social të Evropës dhe arritja e rritjes së duhur ekonomike dhe e mundësive të punësimit.

Kur të garantohet kjo, Ju mbështesni në radhë të parë bisedimet e anëtarësimit me Kroacinë dhe shtetet e Ballkanit. Dhe këtu ka ndikim të veçantë koncepti Juaj historik për bashkëpunimin shumëpalësh. Ju keni një interes të veçantë për anëtarësimin dhe deklaroheni për faktin, që fillimi i bisedimeve të mos ndërvohet nga rezultatet e Gjykatës për Krimet e Luftës, por të vendosen kritere të mëvetësishme. Dhe argumentoni duke thënë, që procedurat e hapura apo tashmë të përfunduara kundër ushtarakëve kroatë para kësaj gjykate e kanë dëshmuar tashmë mjaftueshëm vullnetin për bashkëpunim të qeverisë kroate. Ju nënvizoni faktin, që bisedimet për anëtarësim mund të ndërpriten në çdo moment, nëse në të ardhmen Kroacia bojkoton bashkëpunimin.

Pas këtyre kandidatëve të parë për anëtarësim, kërkesës së Turqisë për anëtarësim Ju i atribuoni një prioritet shumë më të pakët. Ju në fakt nuk pozicionoheni në mënyrë strikte kundër pranimin të Turqisë, por vini vazhdimisht dhe me forcë në dukje deficitet aktuale të Turqisë në plotësimin e kriterëve të anëtarësimit dhe nxisni shtyrjen e kufirit kohor për fillimin dhe zhvillimin e bisedimeve. Argumenti Juaj i veçantë është që midis angazhimit të Qeverisë për reformimin e legjisllacionit dhe zbatimit në realitetin turk ka një boshllëk shumë të madh – para së gjithash në çështje të papunësisë, varfërisë, punës së fëmijëve dhe punësimit ilegal. Krahas kësaj Ju ngulni këmbë në verifikimin e realizueshmërisë së anëtarësimit të Turqisë në BE për nga pikëpamja ekonomike dhe sociale.

Në tërësi Ju preferoni ndërtimin e një raporti special bashkëpunimi mes BE-së dhe Turqisë. Në këtë kontekst Ju mund të tematizoni krijimin e një Unioni më vete turko-evropian.

Deputetët/et e SPE nga Gjermania në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Gjermania dhe BE – pozicioni i SPD

Gjermania është një ndër gjashtë vendet themeluese të Komuniteti Ekonomik Evropian dhe ka zhvilluar që prej fillimeve të bashkimit evropian një politikë tejet miqësore përkundrejt integritit. Kjo argumentohet edhe nga pikëpamja historike me faktin që pas luftës së dytë botërore integrimi evropian i ofroi Gjermanisë mundësinë, jo vetëm të kapërcente armiqësinë e saj disavjeçare me Francën dhe ta shndërronte atë në një raport mirëbesimi por, përtej kësaj, të rifitonte përmes pjesëmarrjes në vendimmarrjen mbikombëtare një sovranitet të pjesshëm dhe vlerësim, si dhe aftësi operacionale në nivel ndërkombëtar. Një Evropë e bashkuar dhe e aftë për të vepruar është një interes elementar i Gjermanisë, ndërsa bashkëpunimi me Francën në kuadër të „motorrit gjermano-francez“ ka prioritet absolut.

Edhe Partia Socialdemokrate e Gjermanisë SPD dëshiron një integrim të mëtejshëm në nivel të bashkimit politik dhe angazhohet që BE-ja të jetë në lartësinë e sfidave të saj. Për këto arsye ajo kërkon zhvillimin e një politike të Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Mbrojtjes, në kuadër të së cilës vendimmarrja me shumicë votash të garantojë aftësinë operacionale të Bashkimit Evropian.

SPD-ja dhe faza e ardhshme e zgjerimit

Gjermania e mbështet për shumë arsye pranimin e shteteve të tjera nga Evropa Lindore dhe Juglindore. Kështu për shembull në nivel të politikeve të sigurisë ka një interes masiv për stabilizimin ekonomik dhe politik të këtyre shteteve. Në raste të ndryshme Gjermania ka sjellë në vëmendje në mënyrë të përsëritur detyrimin historiko-moral për të mundësuar përfshirjen e shteteve evropiano-lindore në BE, në mënyrë që të kapërcehet kështu ndarja jo e natyrshme me ta. Por në të njëjtën kohë Gjermania është vendi që konfrontohet më fort se të gjitha vendet e tjera me sfidat sociale dhe ekonomike, të cilat rrjedhin nga një fazë e re eventuale e zgjerimit, si p.sh.. lëvizjet e migracionit nga lindja në perëndim dhe emigrimi i të ashtuquajturës „fuqi e lirë punëtore“.

Megjithë disa rezerva të pakta, SPD e konsideron zgjerimin në drejtim të lindjes në kontekstin e lirisë së lëvizjes për qëllime punësimi, si përfitim të të dy palëve dhe thekson këtu shtrirjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mbrojtjen nga emigrimi ilegal si dhe avantazhet ekonomike të një tregu të brendshëm të zgjeruar.

Ndaj këtu kërkohet një koncept afatgjatë politik dhe ekonomik, që rajonit t'i ofrohet një perspektivë paqeje, lirie dhe mirëqenieje. Pikënisja e duhur është Pakti i Stabilitetit konceptuar nga BE për Ballkanin. Ky pakt stabiliteti duhet zhvilluar më tej dhe mund të përfundojë në anëtarësimin në BE.

Në lidhje me fqinjët e rinj lindorë të Bashkimit Evropian, siç janë vendet e Ballkanit, partia kërkon zgjerimin konsekuent të instrumentave kontraktualë me synimin e bashkëpunimit në partneritet, por që nuk çojnë në mënyrë automatike në anëtarësimin në BE. Megjithatë SPD është angazhuar që në vitin 2001, që mundësitë e ndikimit në palët konfliktuale maqedonase dhe shqiptare të ezaurohen jashtë nivelit të detyrimit fizik. SPD është përpjekur gjithmonë ta shmangë dhunën si mjet të zgjidhjes së konflikteve politike. Në këndvështrimin e saj shteti në nevojë, Maqedonia, është i varuar nga ndihma e jashtme ekonomike dhe mund të vihet në

lëvizje vetëm nëpërmjet një kombinimi mes tërheqjes dhe presionit. Forcat militante shqiptare e kanë bazën e tyre materiale në zonën e ndikimit të komunitetit ndërkombëtar: në Kosovë, Shqipëri si dhe në disa vende të caktuara të diasporës. Mundësia e ndërprerjes së „ushqimit“ të luftës së atjeshme civile, në vlerësimin e SPD, është shfrytëzuar deri më tani në mënyrë të pamjaftueshme.

Ndërsa për Kroacinë, një të ardhme të afërt, duhet të krijohet në një perspektivë anëtarësimi, nëse qeveria kroate do të deklarohet e gatshme të bashkëpunojë pa kushte me Gjykatën Ndërkombëtare për Kriminelët e Luftës për Ish-Jugosllavinë.

Në lidhje me çështjen e Turqisë mbështeten perspektiva e anëtarësimit të ardhshëm dhe hapja e bisedimeve dhe kjo konsiderohet si shans historik për të gjithë kontinentin. SPD nënvizon si efektin mbështetës të opsionit të anëtarësimit për përpjekjet e konsiderueshme të Turqisë për reforma nga njëra anë, ashtu edhe avantazhet gjeostrategjike dhe ekonomike për BE-në dhe Gjermaninë nga ana tjetër.

Përsa i përket argumentit që BE nuk është në gjendje të përballojë anëtarësimin e Turqisë, SPD fton në analizën si më poshtë:

- Nga momenti i vendimit në Kopenhagen deri në pranimin e dhjetë anëtarëve të rinj datë 1 maj 2004 u deshën 11 vjet. Shoqëritë në Poloni, Hungari dhe Republikën Çeke si dhe në të gjitha shtetet e tjera kandidatë për anëtarësim janë sot shumë më ndryshe nga ç'ishin në vitin 1993. Edhe BE-ja ka ndryshuar.
- Turqia pret një kohëzgjatje bisedimesh deri në dhjetë vjet, vetë kryeministri Erdogan ka menduar si vit anëtarësimi vitin 2019. Në rastin e anëtarësimit të Turqisë në 15 vjet, pra në vitin 2020, do të ketë ndryshuar jo vetëm Turqia, por edhe BE nuk do të jetë më ajo e sotmja. Deri në atë moment edhe BE do të ketë përfunduar reformimin e vet të brendshëm. Me miratimin e Kushtetutës Evropiane do të jenë krijuar premiset, që të garantohet aftësia funksionale e Bashkimit Evropian në rast të pranimit të Turqisë dhe të shteteve të tjera të Evropës Juglindore.

Turqia është me interes të lartë për BE-në edhe si partner ekonomik në nivel tregu. BE-ja dhe Gjermania përfitojnë që sot në një masë të konsiderueshme nga marrëdhëniet e intensifikuara ekonomike prej vendosjes së Bashkimit Doganor. Prej vitesh Gjermania është partneri më i rëndësishëm tregtar i Turqisë, e cila nga ana e saj 50% të tregtisë së jashtme e ka me Bashkimin Evropian. 30% e kësaj shifre i takon Gjermanisë. Veç kësaj Gjermania ka një pozicion udhëheqës në investimet direkte në Turqi. Nga ana tjetër në Gjermani ka më tepër se 40.000 sipërmarrje turke, që ofrojnë vende pune shtesë.

Ekonomia e Turqisë shënon zhvillime pozitive. Ajo ka dëshmuar ritme mesatare rritjeje prej 3% në periudhën 1990-2002. Në vitin 2003 madje PBB është rritur në masën 5%. Edhe problemi i inflacionit vitet e fundit është mundur të zbutet.

Taktika:

Ju si deputet/e i/e SPD në Parlamentin Evropian keni shpresuar gjithmonë në dhënien fund të konfliktit mes lindjes dhe perëndimit, me qëllim që më së fundi edhe shtetet evropiano-lindore të mund të bëhen anëtarë të Bashkimit Evropian, i cili për një kohë të gjatë ka mbartur vetëm tipare evropiano-perëndimore. Krahas kësaj Ju e konsideroni zgjerimin si një shans të madh për ekonominë, në mënyrë që të hapen tregje të reja dhe kështu të mundësohen vende të reja pune. Në terma afatgjatë përfitimet e pritshme dominojnë mbi barrën e domosdoshme të afateve të mesme.

Ju nuk e fshihni faktin që dëshironi ta shihni Gjermaninë si fuqi udhëheqëse në Evropë, të angazhuar para së gjithash në çështje të mbrojtjes së mjedisit, të standardeve sociale dhe të mbrojtjes së konsumatorit.

Në të njëjtën kohë Ju denonconi barrën deri më tani të lartë financiare, që i duhet Gjermanisë të mbajë për shkak të kontributit të saj në asistencën e BE-së për shtetet anëtare të BE-së me konjunkturë të dobët. Kjo temë si dhe ajo e „shuarjes së fshatarësisë” janë pika që kritikohen vazhdimisht gjatë takimeve me elektoratin Tuaj. Disa prej zgjedhësve Tuaj kanë frikë nga një fazë e re e zgjerimit të BE-së – duke patur parasysh këtu Turqinë – pasi mendojnë se do të kenë më shumë detyrime financiare si pasojë të transfertave të detyrueshme, dhe krahas këtyre merret në konsideratë rreziku i kriminalitetit në rritje dhe vënia në diskutim e tregut bujqësor evropian ekzistues. Te shumë zgjedhës ekziston frika e konkurrencës nga fuqia e lirë punëtore në tregun e punës dhe Ju nuk mund t'i injoroni komplet këto shqetësime të zgjedhësve Tuaj. Për këtë arsye Ju mbështesni idenë që, sikurse edhe gjatë fazës së parë të zgjerimit në drejtim të lindjes, në fusha të tilla të ndjeshme siç është lëvizja e lirë e fuqisë punëtore të fiksohen afate tranzicioni.

Në rastin e Kroacisë Ju i mbeteni besnik linjës tradicionale të Gjermanisë dhe mbështesni hapjen e bisedimeve të anëtarësimit. Por vendosni si kusht një bashkëpunim më të mirë të Kroacisë me Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet e Luftës.

Edhe në lidhje me bisedimet e anëtarësimit me Turqinë Ju mbështesni hapjen e tyre, nëse Turqia plotëson kriteret politike të Kopenhagenit, ku me siguri Ju jeni të vetëdijshëm që në fushën e lirisë fetare, të mbrojtjes së minoriteteve dhe në fushën e shtetit ligjor ka ende shumë për të bërë. Ju e nxisni Turqinë të eliminojë sa më shpejt të jetë e mundur deficitet. Nëse garantohet kjo, atëherë në vlerësimin Tuaj ka më shumë pika që flasin për anëtarësimin e ardhshëm të Turqisë: procesi i reformave në Turqi do të mbështetet dhe konsolidohet, zgjerimi i tregut të brendshëm do të sjellë për të gjitha palët avantazhe ekonomike, pesha e politikës së jashtme të një Bashkimi Evropian të zgjeruar do të rritet dhe një vend anëtar si Turqia mund të funksionojë si një urë me botën islamike.

Turqia në sytë Tuaj është e lidhur historikisht me Evropën dhe bën pjesë në shtetet evropiane, dhe këtë BE-ja e ka konfirmuar duke i njohur asaj zyrtarisht statusin e vendit kandidat. Kultura dhe feja nuk mund të përdoren si argumente kundër anëtarësimit të Turqisë, duke qenë se BE është një komunitet vlerash dhe jo një komunitet fetar, dhe jeton pikërisht duke u mbështetur në larminë kulturore garantuar në marrëveshje.

Por mos harroni që ndër zgjedhësit Tuaj mbizotërojnë ndjesi të ndryshme lidhur pikërisht me lëvizjet eventuale të emigrantëve pas një anëtarësimi të mundshëm të Turqisë dhe që çështja e Turqisë në kuadrin politik evropian është një çështje tejet e diskutueshme. Pra mos u shfaqni në mënyrë shumë ofensive për të mos u izoluar shumë herët si dhe kërkoni përcaktimin e afateve të tranzicionit për lëvizjen e lirë dhe tregun e punës në përputhje me zgjedhësit Tuaj. Në rast rezistence sillni në vëmendje, që askush nuk dëshiron ta marrë Turqinë që ditën e nesërme në union; këtu bëhet fjalë për një proces, i cili do të zgjasë të paktën një dhjetëvjeçar. Për këtë arsye argumentat, që jepen sot lidhur me aftësinë a pamjaftueshme operacionale të BE-së në rast zgjerimi, janë të pabaza.

Deputetët/et e SPE nga Malta në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Malta në BE dhe zgjerimi – pozicioni i Partit Laburista

Zhvillimet politike në Maltë dominohen para së gjithash nga dy parti të mëdha, Partia e Punës Partit Laburista dhe Partia Nacionaliste Konservativo-Liberale. Të dyja këto parti kanë përbërë deri më tani në mënyrë të alternuar shumicën në Parlamentin e Maltës, pra edhe qeverinë e vendit.

Në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian në Maltë nuk ka patur një konsensus të përgjithshëm politik. Në vitin 1990 Malta bëri kërkesën e saj për anëtarësim në BE, kur ishte nën qeverisjen e Partisë Nacionaliste. Kjo kërkesë u shfuqizua nga Partit Laburista e zgjedhur në pushtet në vitin 1996. Pas ndërrimit të radhës të qeverive në vitin 1998 Malta përsëriti kërkesën e saj për anëtarësim në BE. Që prej këtij momenti, anëtarësimi në BE ka qenë oobjektivi më i rëndësishëm i politikës së jashtme malteze. Në referendumin e datës 8 mars 2003 53,6 % e popullsisë u shprehën për anëtarësimin e Maltës në Bashkimin Evropian. Duke ndjekur tendencën e referendumit dhe përshëndetur përafrimin me BE-në në zgjedhjet e vitit 2003 u rizgjodh Partia Nacionaliste. Në datën 1 maj 2004 Malta hyri në BE dhe i zuri kështu vendin Luksemburgut si shteti më i vogël i Unionit.

Partia Nacionaliste shënoi një fitore tjetër në zgjedhjet e pranverës 2008.

Partit Laburista, themeluar në vitin 1921, ka qenë tepër kritike përkundrejt anëtarësimit të Maltës në BE. Në fakt kjo parti ka mbështetur gjithmonë një bashkëpunim të konsoliduar politik dhe ekonomik me BE, si në kuadër të Marrëveshjes së Asociimit dhe në formën e një zone të tregtisë së lirë, e megjithatë anëtarësimin në BE ajo e ka refuzuar për motive të ndryshme.

Partit Laburista përfaqësonte pikëpamjen, që një union politik do të mbarte detyrime dhe barra tepër të mëdha për Maltën. Partit Laburista druante gjithashtu, se Malta do të kishte efekte ekonomike negative, që sipas këndvështrimit të saj do të çonin në rritjen e varfërisë dhe përforcimin e dallimeve sociale. Por që prej anëtarësimit në BE partia ka pësuar një proces shndërrimi dhe përfaqëson ndërkohë një linjë gjerësisht proevropiane, edhe pse jo krejt jokritike. Aktualisht Partit Laburista është partia më e madhe opozitare e Maltës. Pjesëmarrja në zgjedhje edhe për shkak të detyrimit për zgjedhje është tradicionalisht shumë e lartë, gjë që u konfirmua edhe në zgjedhjet e Parlamentit Evropian të vitit 2004. Me 82% pjesëmarrje në zgjedhje Malta shquan nga shtetet e tjera anëtare që karakterizohen nga rekorde të ulëta.

Më 1 janar 2008 Malta futi në përdorim Euron.

Në Parlamentin Evropian Partit Laburista bën pjesë në fraksionin e SPE. Megjithë përkatësinë e saj në SPE, që mbështet fazat e reja të zgjerimit të BE, në këtë pikë Partit Laburista është e një pikëpamjeje tjetër. Edhe pse pozicioni tradicionalisht skeptik i Partit Laburista në lidhje me temën e BE-së ka ndryshuar dhe kjo parti është tanimë qartësisht më pozitive përkundrejt BE, partia tregohet disi e tërhequr në lidhje me fazat e reja të zgjerimit. Ajo në fakt nuk është një kundërshtar i ashpër i zgjerimit, por megjithatë disi skeptike.

Taktika:

Me gjithë përkatësinë Tuaj në fraksionin e SPE Ju nuk jeni dakord pa kushte me fazat e reja të zgjerimit të BE, por jeni më shumë skeptik në lidhje me pranimin e anëtarëve të rinj, pavarësisht nga pozicioni gjeografik apo madhësia e shteteve.

Frika Juaj më e madhe është që arritjet ekonomike dhe veçanërisht ato sociale në BE do të rrezikohen nga pranimi i shteteve të tjera anëtare ekonomikisht më të varfra. Pasoja të kësaj mund të jenë pabarazi më të theksuara sociale dhe rreziku i një varfërie në rritje.

Por këtë pozicion Ju shpreheni me kujdes dhe në mënyrë diplomatike, duke qenë se SPE është e një pikëpamjeje tjetër, pikërisht për mbështetjen e pranimin të anëtarëve të rinj. Ju jeni i vetëdijshëm për faktin që jeni një parti e vogël me vetëm tre deputetë në Parlamentin Evropian dhe që ndikimi Juaj, për shkak të numrit të vogël të vendeve në Parlament, është i kufizuar. Në këtë kontekst duhet të kërkonti aleatë për pozicionin Tuaj, por njëkohësisht të jeni të hapur për kompromise.

Duke u nisur para së gjithash nga pozicioni Juaj gjeografik Ju mbështesni idenë e zgjerimit të përpjekjeve të BE-së në rajonin e Afrikës së Veriut.

Deputetët/et e SPE nga Suedia në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Suedia në Bashkimin Evropian – Pozicioni i Sveriges Socialdemokratiska Arbetareparti

Që në fillimet e shek. 19-të Suedia ka qëndruar kryesisht larg zhvillimeve në kontinentin evropian. Përmes politikës së saj asnjnjëse, dhe për pasojë edhe izolimit politik, vendi pati një periudhë të gjatë qetësi, që bëri që përfshirja e Suedisë në Komunitetin Evropian të mos konsiderohej si diçka e domosdoshme. Nga ana tjetër Evropa për Suedinë duhej të ishte vetëm një kontinent i tregtisë së lirë mes shtetesh sovraane. Ishte „Këshilli Nordik“, krijuar më 1952, ai që bëri të mundur një shkëmbim politik më intensiv me shtetet direkt fqinje të Suedisë.

Traktati i Maastricht-it (1993), pëmbysja e regjimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe marrëdhëniet gjithnjë e më të ngushta tregtare mes Bashkimit Evropian dhe Suedisë, çuan në një riorientim të politikës së Suedisë për Evropën. Më 1 janar 1995 Suedia u bë anëtare e Bashkimit Evropian. Por referendumi për anëtarësim në Bashkimin Ekonomik Monetar në vitin 2003 pati rezultate negative, Kështu që vendi nuk e futi në përdorim monedhën Euro. Kjo është një shenjë që tregon se popullsia suedeze nuk ka hequr dorë ende nga qëndrimi i vet tejet kritik në drejtim të BE-së.

Anëtarësimi i Suedisë në BE udhëhiqet së pari nga interesi për garantimin e bazës për rritje ekonomike, punësim dhe mirëqenie përmes aksesit të lirë në tregjet ndërkombëtare. Veç kësaj suedezyt janë shumë krenarë në lidhje me arritjet e modelit të tyre social, mbrojtjes së mjedisit dhe mënyrës transparente të qeverisjes së vendit, të cilat ata nuk duan t'i vënë në rrezik me politikën evropiane. Ndaj edhe pikat më të rëndësishme të politikës suedeze për Evropën, janë politikat e punësimit dhe rritjes ekonomike, barazia gjinore, mbrojtja e mjedisit dhe e konsumatorit, legjitimitimi demokratik dhe krijimi i institucioneve evropiane afër me qytetarin. Krahas tyre fusha të tjera të rëndësishme për Suedinë dhe Partinë Socialdemokrate të Punëtorëve.

Partia Socialdemokrate e Punëtorëve është partia më e vjetër në Suedi, themeluar në vitin 1889. Që prej pjesëmarrjes së saj të parë në qeveri në vitin 1917 ajo ka qenë pothuaj 70 vjet rresht parti qeveritare dhe pas një ndërprerjeje të shkurtë u rizgjodh sërish në qeveri në vitin 2002. Që prej zgjedhjeve të vitit 2006 ajo gjendet sërish në opozitë. Në Parlamentin Evropian Partia Socialdemokrate e Punëtorëve ka pesë nga gjithsej 19 deputetët suedezyt.

Partia Socialdemokratike e Punëtorëve dhe zgjerimi.

Objektivi prioritar që e lidhte Suedinë me zgjerimin e fundit, pikërisht shansi historik i pranimit në BE i fqinjëve balltikë dhe vendeve partnere në tregti, është përmbushur që prej datës 1 maj 2004. Megjithë disa rezerva Suedia e ka mbështetur në tërësi gjithë raundin e fundit të zgjerimit gjatë kryesisë së saj të Këshillit të Bashkimit Evropian në vitin 2001 dhe është e hapur edhe tani përkundrejt vijimit të kësaj politike të zgjerimit. Argumenti kryesor këtu është që forca tërheqëse e BE ka një ndikim mbresëlënës në progresin demokratik, ekonomik dhe social të vendeve kandidate, gjë që më pas ka efekt pozitiv në situatën e sigurisë në Suedi dhe mbarë Evropën.

Krahas kësaj për motive historike dhe gjeografike Suedia i kushton një rëndësi të veçantë partneritetit të ngushtë me Rusinë. Me pranimin e shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore qeveria premtun në të njëjtën kohë impulse të reja për marrëdhëniet mes BE-së dhe Rusisë. Nga ana tjetër Suedia në politikën e saj të zgjerimit duhet të marrë në konsideratë faktin që Rusia i ndjek me shumë mosbesim përpjekjet e përafrimit të ish republikave të Bashkimit Sovjetik me BE-në.

Më tej Partia Socialdemokrate e Punëtorëve, megjithë mbështetjen e procesit të zgjerimit, është mbrojtëse e flaktë e aplikimit strikt të Kritereve të Kopenhagenit si kusht për anëtarësimin. Këto kritere duhet të jenë njësi matëse për të parë nëse vendi është i aftë të anëtarësohet apo jo. Në këtë kontekst për Suedinë është me rëndësi të konsiderueshme ruajtja e standardeve sociale dhe mjedisore nga shtetet candidate, në mënyrë që të parandalohet rrezikimi i modelit social suedez përmes zgjerimit.

Si vend i madh kontribues në BE Suedia druhet se mos do t'i duhet të mbartë një pjesë joproporcionale të kostove të zgjerimit, dhe për këtë arsye i mëshon idesë së vendosjes së kufijve të qartë të kuadrit financiar si dhe reformës së një politike të përbashkët agrare që të jetë në gjendje të përballojë shpenzimet, përpara se të pranohen anëtarë të rinj.

Taktika:

Sie përfaqësues/e e Partisë Socialdemokrate Qeveritare Ju mbështesni përgjithësisht pranimin e anëtarëve të tjerë në BE. Por duke marrë në konsideratë shqetësimet kritike të popullsisë suedeze përkundrejt BE-së Ju e vini miratimit Tuaj disa kushte të caktuara. Për Ju e domosdoshme është që vendet candidate për anëtarësim të përmbushin Kriteret e Kopenhagenit dhe të garantojnë në mënyrë të veçantë respektimin e standardeve sociale dhe mjedisore. Gjithashtu për Ju duhet të garantohet që transparenca dhe legjitimitimi demokratik i strukturave vendimmarrëse evropiane të vazhdojë të ruhet dhe përforcohet edhe pas zgjerimit. Në përfundim Ju kërkoni që brenda vendeve anëtare aktualisht të kufizohen në mënyrë kontraktuale kostot e zgjerimit si dhe, përpara pranimin të vendeve të reja me karakter të theksuar bujqësor, të reformohet politika agrare evropiane, e cila mbart kosto intensive, si dhe të hapet përkundrejt lëvizjeve të tregut.

Edhe përsa i përket Ballkanit Ju konstatojnë një lidhje të qartë mes perspektivës evropiane dhe përsheptimit të procesit të reformave dhe stabilizimit. Ju mbështesni idenë, që paralelisht me aktivitetet për stabilizimin e rajonit duhet përgatitur edhe integrimi i tij në strukturat evropiane. Kjo nuk duhet të ndodhë detyrimisht përmes anëtarësimit në BE, por mund të marrë edhe formën e partneriteteve të veçanta.

Nga ana tjetër Ju përjashtoni mundësinë e hapjes së bisedimeve të anëtarësimit me të gjitha ato shtete, që nuk bashkëpunojnë në mënyrë të angazhuar me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës pranë Kombeve të Bashkuara.

Edhe për Turqinë Ju aplikoni të njëjtat njësi matëse si për kandidatët e tjerë: Nëse vendi përmbush kriteret dhe çon përpara në mënyrë konsekuente procesin e reformave, Ju e mbështesni hapjen e bisedimeve të anëtarësimit. Në këtë kontekst Ju jepni një sinjal pozitiv dhe nxisni për realizimin e reformave të përcaktuara. Por i bëni gjithashtu të qartë Turqisë se përpara anëtarësimit faktik duhen zgjidhur shumë probleme të tjera, sikurse është çështja e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e gruas, heqja e torturës dhe situata e kurdëve.

Deputet/e i/e Komisionit të Jashtëm të Parlamentit Evropian nga Britania e Madhe

www.labour.org.uk

Britania e Madhe në BE – Pozicioni i Labour-Party

Interesat e Britanisë së Madhe janë globale dhe nuk përqendrohen vetëm në Evropë kushtëzuar kjo nga roli i saj i hershëm si fuqi botërore dhe nga marrëdhëniet me ish-shtetet koloniale. Ndaj në të shkuarën Britania e Madhe shpesh ka luajtur një politikë të dyfishtë ose indiferente dhe izolacioniste kundrejt BE. Ajo e shihte kuptimin e integritimit evropian para së gjithash në sektorin ekonomik, ndërsa integritimin e mëtejshëm politik – lidhur kjo me lëshimin e një pjese të sovranitetit shtetëror institucioneve mbikombëtare të BE – e shihte me sy skeptik. Megjithëse Politika e BE ndërkohë ka marrë një rëndësi prioritare për Britaninë e Madhe, aleanca me SHBA është po kaq e rëndësishme.

Nën qeverinë e Tony Blair Britania e Madhe u përpoq kohët e fundit të ishte një partner drejtues dhe serioz brenda BE dhe të angazhohej për një Evropë të paqte dhe demokratike të mirëqënies dhe stabilitetit. Angazhimin e vet politik kryeministri i Laburistëve e konsideron si rrugën më të mirë për të mbrojtur interesat kombëtare dhe për të rifituar ndikimin e humbur, me qëllim që të ndërtojnë së bashku me shtetet e tjera anëtare një të ardhme të begatë dhe të nxjerrin së këtejmi më të mirën për vendin e vet.

Brenda BE Britania e Madhe punon për reformat ekonomike, të cilat mendohet të ndihmojnë nëpërmjet liberalizimit të tregut, privatizimit dhe drejtësisë sociale për të krijuar mundësi punësimi dhe për të sjellë risi. Për Britaninë e Madhe ka rëndësi edhe zgjerimi i Politikave të Përbashkëta për Punët e Jashtme dhe të Sigurisë si dhe i Politikave të Përbashkëta të Mbrojtjes. por kjo duhet të realizohet në nivel ndërshtetëror duke mos lënë pas dore aleanca të tjera – para së gjithash NATO-n.

Laburistët dhe zgjerimi i ardhshëm

Zgjerimet e Bashkimit Evropian Partia Laburiste i vlerëson si një shans historik dhe mundësi zhvillimi për shtete që aspirojnë anëtarësimin njësoj si edhe për shtetet anëtare të BE. Britania e Madhe ka përkrahur dy raundet e fundit, deri tani më të mëdhatë, të zgjerimit, 2004 dhe 2007, gjatë të cilave BE ka pranuar gjithsej 12 shtete të reja anëtare. BE është tanimë tregu i brendshëm më i madh në botë. Dhe me këtë lidhen shpresa për rritje ekonomike dhe progres teknologjik në të gjithë BE sikurse edhe stabilitet në reformat politike dhe ekonomike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Edhe në zgjerimet e tjera Britania e Madhe është për „fair play”: Çdo vend duhet vlerësuar në mënyrë individuale dhe objektive në varësi të progresit të vet në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagen-it. Britania e Madhe shpreson që nëpërmjet anëtarësimeve në BE të ketë stabilitet dhe mirëqenie para së gjithash në në mbarë Ballkanin, duke krijuar kështu një garanci kundër luftrave dhe trazirave, sikurse ka qenë përvoja e këtij rajoni në vitet '90. Për arsye kryesisht strategjike Britania e Madhe, parimisht, e mbështet edhe anëtarësimin e Turqisë.

Përtej kësaj, për Moldavinë dhe Ukrainën ajo e pranon në parim mundësinë e anëtarësimit, ndërsa për vende të tjera ajo nuk sheh shanse reale të një pranimi në 20 vitet e ardhshme, pasi për këtë qëllim këto vende janë ende shumë larg normave politike, ekonomike dhe juridike të BE.

Zgjerimet e BE janë me prioritet të lartë për Partinë Laburiste, për më tepër që ajo me pozicionimin e vet proevropian ndesh në skepticizmin dhe mungesën e interesit të një pjese të konsiderueshme të popullsisë dhe shtypit. Argumentet e Konservatorëve britanikë kundër vënies në përdorim të euros dhe kundër Kushtetutës së BE bien në një tokë po aq pjellore sa edhe frika se mos zgjerimet e tjera sjellin barra të konsiderueshme financiare për Britaninë e Madhe. Gjithsesi Konservatorët, me qëndrimin e tyre skeptiko-evropian po ia dalin të dërgojnë në Strasburg gjithnjë e më shumë deputetë se sa Partia Laburiste.

Taktika:

Ju jeni militant i New Labour dhe luftoni në vendin Tuaj prej shumë vitesh për një emër më të mirë të Bashkimit Evropian në Mbretërinë e Bashkuar. Zgjerimet e BE Ju i shihni si shans të madh historik, tregu i zgjeruar evropian dhe zona e euros do të ofronin edhe për sipërmarrjet e Britanisë së Madhe një mundësi më të mirë për veprimtari dhe investime.

Në të njëjtën kohë Ju shikoni rrezikun që sipërmarrësit të kërkojnë vendet „e lira“ si vende prodhimi, duke provokuar kështu një zhvendosje të kushteve sociale të fillimit. Por në një integrim të mirëorientuar dhe me mbështetjen e vendeve kandidate Ju shihni shansin e fundit për t'i dalë përpara këti fenomeni „Sozialdumping“.

Edhe te Ju ekziston frika që anëtarë të rinj e të varfër të BE mund të lidhen me shtete të Evropës Jugore dhe Lindore duke iu bërë shpejt barrë kontribuesve të mëdhenj (siç është Britania e madhe) në çështje financiare.

Kështu, Ju merrni pjesë në seancat e Parlamentit me ndjesi të ndryshme. Meqenëse elektorati Juaj vjen nga nja rajon i pazhvilluar ekonomikisht me papunësi të lartë Ju ndodheni nën presionin masiv të zgjedhësve Tuaj. Ndaj prezantohuni në Komision dhe grupin Tuaj parlamentar si evropian i bindur dhe mbështetës i Unionit të zgjeruar. Por ndërkohë përpiquni t'i jepni procesit të anëtarësimit një drejtim të tillë, që kostot dhe përfitimet të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme dhe para së gjithash të ruhen interesat Tuaja.

Sillni në vëmendje problemet e të gjitha shteteve që duan të anëtarësohen (korrupsion i lartë, krim i organizuar, trafik qeniesh njerëzore si dhe probleme në realizimin e reformave). Edhe varfëria e përhapur shumë është një problem tejet i rëndë dhe shumë rajone, veçanërisht ato rurale, janë të shkëputura nga zhvillimi.

Kjo vlen, sipas Jush, para së gjithash për Kosovën dhe Malin e Zi. Kundrejt Kroacisë dhe Maqedonisë Ju jeni pozitiv. Ju mbështesni pozicionin e Maqedonisë në lidhje me debatin për emrin me Greqinë.

Referuar Turqisë Ju ndani në fakt shumë rezerva të deputetëve të tjerë (p.sh. shkeljet e të drejtave të njeriut si tortura dhe gjendja e kurdëve) por nga ana tjetër sillni në vëmendje rëndësinë e madhe të Turqisë për Evropën. Duke qenë prej kohësh anëtar i NATO-s dhe shembull për një demokraci të shekullarizuar në një shtet musliman ky vend shihet si një hallkë lidhëse politike dhe ekonomike mes Euroazisë, Lindjes së Afërt dhe Perëndimit, tepër e rëndësishme për nga pikëpamja gjeostrategjike dhe ajo e politikave të sigurisë. Pa një perspektivë konkrete dhe të shpejtë anëtarësimi përpjekjet e atjeshme të reformave mund të dështojnë dhe të fitojnë epërsi forcat islamike. Në këtë kontekst propozoni bisedime graduale anëtarësimi me mbështetje dhe kontroll intensiv nga ana e BE. Në këtë mënyrë Turqia do të kishte kohën e duhur për të realizuar reformat e veta politike, juridike dhe ekonomike dhe BE, nga ana tjetër, do të mund të përgatitej ngadalë për këtë anëtarësim.

Në parim Ju nuk përjashtoni anëtarësimin e një vendi nga Ballkani Perëndimor apo të Turqisë. Por tërhiqni vëmendjen në lidhje me rrezikun e vendimeve të nxituara. Shtetet që do të bëhen anëtare, duhet të dëshmojnë se realisht kanë arritur një nivel ai ai i BE.

FRAKSIONI ALEANCËS SË LIBERALËVE DHE DEMOKRATËVE PËR EVROPËN (ALDE)

Fraksioni Liberal i ka rrënjët e tij në traditën liberale të iluminizmit dhe e konsideron veten si forcë ekonomike të liberalizmit ekonomik në Parlamentin Evropian. Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën – Alliance of Liberals and Democrats for Europe (ALDE) – është për momentin, me 104 deputetët e vet, fraksioni i tretë më i fortë në Parlamentin Evropian. Ajo ka qenë gjithmonë partia, që është shfaqur me idetë e ekonomisë së tregut dhe të mirëqenies.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian mbështetet nga Liberalët si një detyrim moral dhe domosdoshmëri politike, por shihet njëkohësisht edhe si nevojë ekonomike. Kështu ata kërkojnë, që në procesin e anëtarësimit të përfshihen të gjitha shtetet që aspirojnë anëtarësimin, dhe nga të cilët plotësohen kriteret e mëposhtme:

- garantimi i institucioneve të qëndrueshme, demokracisë, shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut
- një ekonomi tregu funksionale dhe afësia për t'i bërë ballë presionit të konkurrencës së Bashkimit Evropian
- Kapaciteti për të marrë përsipër detyrimet që mbart anëtarësimi si dhe përmbushjen e objektivave të Unionit

Po kështu si kusht paraprak për anëtarësimin në Bashkimin Evropian ALDE konsideron edhe reformën institucionale në BE si dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë orientuar për nga tregu dhe konkurrenca.

Fraksioni mbështet Politikën e Përbashkët në Punët e Jashtme, Çështje të Mbrojtjes dhe të Sigurisë, me anë të së cilës mund të reagohet me masa paqeruajtëse kudo, ku konstatohen shkelje të të drejtave të njeriut.

Për ato vende të Ballkanit, që nuk mund të konsiderohen ende si vende kandidate, Liberalët kërkojnë anëtarësimin në BE, në mënyrë që të pengojnë rënen e këtyre vendeve në kaos dhe dhunë. Në këtë kontekst fraksioni kërkon një strategji të përbashkët të BE-së për mbështetjen e bashkëpunimit rajonal të vendeve të Evropës Juglindore, për të shtrirë më tej stabilitetin në këto vende si dhe për të përforcuar zhvillimet demokratike e të orientuara për nga tregu si dhe për të hapur perspektivën e anëtarësimit në terma afatgjatë. Në këtë kontekst ALDE i kushton rëndësi të veçantë ndër të tjera edhe një asistencë më efikase financiare dhe krijimit të mediave pluraliste. Procesi demokratik i reformave në Turqi duhet mbështetur, duke e siguruar vendin për perspektivën e anëtarësimit.

Në mënyrë të veçantë fraksioni përshëndet nënshkrimin e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit të BE-së me Bosnje-Hercegovinën, Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Këto marrëveshje konsiderohen si një hap tjetër i rëndësishëm i këtyre shteteve në drejtim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Detyra Juaj si anëtar i fraksionit

Perfytyroni se jeni anëtar i fraksionit. Për realizimin e interesave Tuaja Ju nevojitet mbështetja e grupimeve të tjera politike, dhe për Ju është tejet e rëndësishme të bëheni të vetëdijshëm që veçanërisht Partia Popullore Evropiane dhe Fraksioni i Partive Socialdemokrate të Evropës luajnë role të rëndësishme në Parlamentin Evropian dhe që në raste të caktuara mund të bllokojnë iniciativat Tuaja, nëse gjen Partnerë më të „vegjël“ koalicioni.

Kështu varet nga Ju të gjeni të mesmen e duhur. Pasi nga njëra anë Ju duhet të kërkoni kompromisin – që mund të çojnë në detyrën e profilit politik – dhe nga ana tjetër fiksimi në pozicionet Tuaja mund të çojë në një dobësim të ndikimit të Parlamentit Evropian, nëse Ju nuk mund të gjeni gjuhën e përbashkët me kolegët Tuaj. Kjo do ta çonte marrjen e vendimit në duart Komisionit dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian

Në çdo fraksion ka ekspertë të veçantë për fusha të caktuara politike. Ju bëni pjesë në „Komisionin për Punët e Jashtme“ dhe punoni kryesisht për çështje të strukturimit të ardhshëm të një Bashkimi Evropian në shndërrim dhe zgjerim. Është në dorën Tuaj të kuptoni dhe analizoni mundësitë dhe rreziqet e zgjerimit. Detyra Juaj është të merreni vesh me anëtarët e tjerë të Komisionit për të përfaqësuar një pozicion të përbashkët në lidhje me çështjen e zgjerimit. Më pas do të nisni të kërkoni mbështetës nga fraksionet e tjera, të krijoni koalicione dhe të diskutoni rreth kësaj tematike në mënyrë kontroverse në parlament, në mënyrë që të arrini të bindni kundërshtarët Tuaj politikë për bindjet Tuaja politike. Por jini të vetëdijshëm: Nuk ka kuptim të flisni pa dëgjuar. Në mënyrë që puna e Parlamentit Evropian të jetë efektive duhet të punoni për të arritur një kompromis, me qëllim që të mund të keni sukses edhe në propozimet e Këshillit të BE-së, edhe nëse ato eventualisht nuk përputhen me linjën e Parlamentit Evropian.

Deputetët/et e „Aleancës së Liberalëve dhe Demokratëve të Evropës“ /ALDE) nga Gjermania në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

FDP-ja dhe integrimi evropian

Partia e Lirë Demokratike është një mbrojtëse e politikës evropiane për bashkim, të cilën ajo e konsideron si një model sukcesi. Bashkimi i Evropës pas Luftës së Dytë Botërore ka ndihmuar në pajtimin e popujve të Evropës me njëri tjetrin, në dhënien fund të Luftës së Ftohtë dhe në mundësimin e bashkimit të Gjermanisë. Në politikën e saj evropiane FDP i vë një theks të veçantë lirisë individuale, demokracisë dhe shtetit ligjor, ekonomisë sociale të tregut dhe tregtisë së lirë. Në mënyrë që Evropa të vazhdojë të mbetet një model ekonomik i suksesshëm, kjo parti u kushton rëndësi edhe orientimit për nga kapacitetet, standardeve të larta të arsimit dhe tregjeve të hapura. BE-ja duhet të zotërojë sërish aftësinë konkurruese në tregun global. Për këtë qëllim duhet përfunduar tregu i brendshëm, duhet forcuar konkurrenca e lirë, dhe parimet e tregut të lirë duhen nxjerrë në plan të parë. Në këtë kontekst FDP u vesh një rol të rëndësishëm institucioneve mbikombëtare, nëse një fushë e caktuar bie në kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit. Edhe në fushën e politikës së jashtme kjo parti mbështet një zgjidhje evropiane dhe mbron idenë e një politike të përbashkët në punët e jashtme dhe çështje të sigurisë, që ta meritojë emrin që ka.

FDP-ja dhe faza e ardhshme e zgjerimit

FDP-ja ka mbështetur tashmë fazën e parë dhe të dytë të zgjerimit drejt lindjes dhe angazhohet për përfundimin e integritit të shteteve të reja anëtare, me qëllim që zgjerimi të mos rëndojë në asnjë rast mbi thellimin. Gjithsesi ajo i mëshon respektimit të kriterëve të Kopenhagen-it, në mënyrë që anëtarësimi të mundësohet vetëm pasi të jenë përmbushur plotësisht këto kritere. Më tej zgjerimi i tregut të brendshëm dhe shtrirja e mëtejshme e stabilitetit dhe parimeve liberale shihen si faktorë tejet pozitivë.

Në lidhje me Turqinë FDP i njuh hapat e bëra përpara të qeverisë turke në përpjekjet për reforma dhe dëshiron të mbështesë në mënyrë aktive vijimin e tyre. Duke qenë se ajo vendos përkundëjt Turqisë të njëjtat kërkesa referuar të drejtave të njeriut, demokracisë dhe politikave ekonomike, konstaton aktualisht mangësi të konsiderueshme, që e bëjnë të largët një anëtarësim të mundshëm. Aq më tepër që BE-ja vetë dhe struktura e saj institucionale nuk janë të përgatitura për një anëtarësim të Turqisë.

Duke iu referuar Ballkanit dhe veçanërisht Kroacisë FDP mbështet hapjen e një perspektive evropiane afatmesme deri afatgjatë si kusht për një situatë të vazhdueshme paqësore dhe të stabilizuar në Evropën Juglindore. Por realizimi i kësaj perspektive varet nga përpjekjet për reforma të vendeve përkatëse, të cilët në këtë mënyrë e përcaktojnë vetë deri në njëfarë mase ritmin. Dhe në fund anëtarësimi individual i një vendi varet nga përmbushja e kriterëve të përmendura, gjë që për disa shtete, sipas FDP-së, është ende shumë larg.

FDP ndihet veçanërisht e lidhur e me Bosnje-Hercegovinën, duke qenë se Përfaqësuesi i Lartë i Komunitetit Ndërkombëtar në Bosnje-Hercegovinë dhe i Ngarkuari Special i BE-së,

Christian Schwarz-Schilling, është anëtar i kësaj partie dhe ka arritur shumë në lidhje me krijimin e një klime paqësore të qëndrueshme dhe një hovi ekonomik gradual.

Krahas kësaj FDP-ja kërkon që Serbisë t'i jepet një sinjal pozitiv. Mundësimi i arrestimit të udhëheqësit të serbëve të Bosnjës Radovan Karadzic është përshëndetur shumë. Ai akuzohet për vrasje etnike, krime kundër njerëzimit, shkelje të ligjit të luftës dhe shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës. Arrestimi i Karadzic është një hap madhështor për Serbinë. Me këtë qeveria e re e Serbisë tregoi guxim dhe vendosmëri. Vetënjohja e saj si pjesë e Evropës duhet marrë siç duket shumë seriozisht.

Në parim kjo parti angazhohet për një politikë gjithëpërfshirëse dhe koherente të BE-së me fqinjët. Ajo kërkon të hedhë poshtë përshtypjen e „Kështjellës Evropë” dhe kërkon që përmes krijimit të një hapësire vlerash të përbashkëta mbi bazën e tregtisë së lirë, integritimit ekonomik dhe marrëdhënieve kulturore, të shtrijë më gjerë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në vendet fqinje të Bashkimit Evropian.

Taktika:

Në parim Ju jeni i hapur për perspektivën e zgjerimit të BE-së, por keni rezerva në lidhje me respektimin e parimeve të caktuara, dhe para së gjithash në vlerësimin e kandidatëve për anëtarësim sipas Kriteve të Kopenhagen-it, referuar veçanërisht ekonomisë së lirë të tregut dhe shtetit ligjor.

Si mbështetës i fazës së parë të zgjerimit për Ju fillimisht është e rëndësishme, që integrimi i shteteve të reja anëtare të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe që faza të tjera të zgjerimit të mos rëndojnë mbi vijimin e integritetit evropian.

Në lidhje me Turqinë përpuni të shmangni dhënien e një mundësie konkrete anëtarësimi dhe referojuni deficiteve ekzistuese të vendit në lidhje me të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve dhe shtetin ligjor. Ju mbështesni idenë e intensifikimit të dialogut mes BE-së dhe Turqisë, me qëllim që kjo e fundit të mbështetet në procesin e modernizimit dhe të përafrimit të saj të mëtejshëm me BE-në. Por njëkohësisht theksoni, që ky proces është në fazën fillestare dhe që për këtë arsye nuk mund të flitet ende për anëtarësim. Si argument tjetër jepni përgatitjen e pamjaftueshme në dimensionin institucional dhe atë të përmbajtjes nga ana e vetë BE-së për të reallizuar pranimin e Turqisë. Si opsion të ardhshëm mund të përmendni mundësinë e një referendumi popullor në lidhje me anëtarësimin e Turqisë. Për pozicionin Tuaj në lidhje me Turqinë duhet të kërkonit partnerë koalicioni veçanërisht në radhët e PPE, në mënyrë që të mund të arrini shumicën.

Përsa i përket Ballkanit dhe veçanërisht Kroacisë ngulmoni për më shumë se perspektivën afatmesme apo afatgjatë të një anëtarësimi të mundshëm, pasi këtu Ju shihni një instrument të stabilizimit politik dhe social të këtyre vendeve dhe të të gjithë Evropës. Gjithsesi edhe në këtë pikë insistoni në respektimin strikt të kriteve të anëtarësimit dhe në verifikimin e çdo rasti kandidatësh si dhe refuzoni një anëtarësim të nxituar nisur thjeshtë nga arsye politike. Në vend të kësaj nxisni zgjerimin e koncepteve ekzistuese të fqinjësisë si ofertë për stabilitetin dhe bashkëpunimin e ardhshëm mes BE-së dhe rajonit, që në fund të fundit do të rezultojnë në anëtarësimin në BE. Përpuni ta bëni popullor këtë pozicion edhe në fraksionet dhe deputetët e tjerë.

Sikurse është bërë e qartë tashmë, dilni hapur edhe në mbështetje të Republikës së Maqedonisë dhe Serbisë, në mënyrë që të mundësohet një përafrim i shpejtë me BE – pse jo edhe një anëtarësim i shpejtë në të.

Deputetët/et nga Holanda të „Alenacës së Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën“ (ALDE) në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Hollanda në BE – Pozicioni i VVD

Hollanda bën pjesë në gjashtë anëtarët themelues të Komunitetit Evropian dhe ka bërë gjithmonë një politikë shumë miqësore përkundrejt integritit. Për shkak të pozicionit gjeografik dhe shtrirjes së saj Holanda ka patur gjithmonë kujdes për të zhvilluar një bashkëpunim intensiv me shtetet fqinje, pra edhe interes për një treg të brendshëm funksional, sepse 75% të produkteve të eksportit kanë për destinacion pikërisht këtë treg.

Një nivel bashkëpunimi i intensifikuar mes disa shtetesh anëtare brenda BE-së është i pashmangshëm për Hollandën. Ndërsa një integrim i diferencuar duhet të pajtohet me objektivat e Marrëveshjes me BE-në. Çdo shtet anëtar duhet të ketë lirinë t'i bashkohet këtij Unioni, nëse arrin të plotësojë kërkesat e një integrimi të shpejtë. Një bashkëpunim i shkallëzuar nuk duhet kurrësi të vërë në rrezik rendin ligjor të Komunitetit apo të dëmtojë në thelb konsistencën e tregut të brendshëm.

Partia liberale Volkspartij voor Vrijheid en Democratie (VVD) është partia e tretë më e fuqishme në vend (18% të votave) dhe ka qenë veçanërisht aktive me pjesëmarrjen e saj në qeveri në vitet tetëdhjetë. Në shumë pika VVD mbështet politikën evropiane të sipërpërkrahur të vendit. Por në një mënyrë më drastike ajo kërkon reformën e bujqësisë dhe orientimin drejt tregut dhe konkurrencës. Ajo mbështet fuqishëm idenë e një Evrope të rajoneve dhe të decentralizimit. Strukturat qendrore në Bruksel duhet të vendosin vetëm në lidhje me atë që nuk mund të vendoset në nivel rajonal apo kombëtar, si p.sh. Politika e Përbashkët për Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë.

Hollanda dhe raundi tjetër i zgjerimit – Pozicioni i VVD

Hollanda deklaroheq qartësisht për integrimin e anëtarëve të tjerë dhe për zgjerimin me kandidatët e tjerë për anëtarësim, ku me zgjerim nënkuptohet shtrirja e idesë evropiane dhe e sigurisë. Gjithsesi vendi shpreson nga një zgjerim i mëtejshëm të përforcojë marrëdhëniet e veta tregtare me vendet e reja evropiano-lindore. Por duhet të garantohet, që zgjerimi të mos çojë në një ndarje të re të Evropës. Krahas kësaj zgjerimi nuk duhet të shkaktojë humbje të efikasitetit dhe aftësive vendimmarrëse të BE-së. Politikat aktuale të BE-së (p.sh. mbrojtja e mjedisit, tregu i brendshëm etj) nuk duhet të humbasin forcën e tyre.

Politika e zgjerimit të VVD mbështetet në pikat e mëposhtme:

- Përkundrejt shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore duhet bërë një politikë, me anë të së cilës të mund të arrihet siguri e qëndrueshme, zhvillim i favorshëm social dhe ekonomik si dhe stabilitet demokratik;
- Tregu i Brendshëm dhe rendi i përbashkët ligjor në Bashkimin Evropian duhen ruajtur; Bashkimi Evropian duhet të reformohet, në mënyrë që të jetë në gjendje të veprojë efektivisht me më shumë anëtarë;
- Të gjitha aspektet e përmendura duhet të realizohen me kosto të përballueshme.

Partia thekson domosdoshmërinë e aplikimit strikt të Kriteve të Kopenhagenit dhe verifikimin individual të respektimit të tyre në vendet e veçanta kandidate, duke patur parasysh veçanërisht funksionimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe shtetin ligjor.

Krahas kësaj VVD duhet, që si të gjitha partitë e tjera, të marrë në konsideratë skepticizmin në rritje të popullsisë hollandeze në lidhje me çështje të BE-së, i cili në një pjesë të mirë lidhet edhe me dyshimet e shumta rreth zgjerimit. Hollandezët kanë gjithnjë e më shumë frikë, që në kontekstin e një Bashkimi Evropian në rritje, të bien gjithnjë e më poshtë, të humbin ndikim. Rol luan edhe frika nga valët masive të emigrantëve dhe nga një „tejhuajëzim“ i shoqërisë. Nisur nga kjo përzierje shqetësimesh të ndryshme hollandezët e refuzuan me shumicë Kushtetutën Evropiane në qershor 2005.

Liberalët hollandezë kanë mbështetur fuqishëm të drejtën e vetëvendosjes së popujve dhe kanë përshëndetur pavarësinë e Kosovës si dhe kërkojnë për Maqedoninë, që kjo të ketë të drejtën të përcaktojë në mënyrë të pavarur emrin e vet.

Taktika:

Ju jeni për zgjerimin, duke qenë se ai sipas mendimit Tuaj sjell vetëm avantazhe në terma afatmesëm dhe afatgjatë si për shtetet anëtare ashtu edhe për ato kandidate dhe do të shtrijë më tej modelin evropian të stabilitetit dhe paqes. Si kusht paraprak për këtë Ju konsideroni reformën e përfunduar të insitucioneve evropiane, të politikës agrare si dhe atë të programeve strukturore.

Edhe nëse mendoni që anëtarësimi të realizohet në një të ardhme të afërt, pozicionohuni për marrjen e disa „masave të sigurisë“. Kështu theksoni objektivin e një integrimi gradual dhe krijimin e një zone të tregtisë së lirë në dhjetë vitet e ardhshme. Ju gjykoni, që për momentin anëtarësimi është i mundshëm vetëm për Kroacinë. Edhe pse gjatë bisedimeve shtetet fillimisht duhet të ndihen të trajtuar në mënyrë të njëjtë, anëtarësimet duhet të realizohen me kushte të ndryshme dhe në momente të ndryshme. Ju i mëshoni aplikimit strikt të Kriteve të Kopenhagenit në marrjen në shqyrtim të kërkesave për anëtarësim.

Në gjykimin Tuaj vendet duhet të jenë në gjendje të përfaqësojnë nivelin e komunitetit, kjo do të thotë që u duhet lënë një fazë e gjatë tranzicioni. Krahas kësaj afate të gjata tranzicioni duhen përcaktuar edhe në çështje të emigracionit. Në këtë kontekst Ju mbështesni idenë e kufizimeve të caktuara përpara i përket lëvizjes së lirë, në mënyrë që të pengohet një emigrim masiv i mundshëm në fillim, derisa tendencat e emigrimit të kenë rënë në një farë mase. Kështu për një fazë të parë duhet të vazhdojnë të aplikohen kontrollet në kufi me vendet e reja anëtare.

Vetëm pasi të jetë e sigurt që nuk do të ketë valë të skajshme emigracioni dhe që në vendet e reja anëtare funksionojnë mekanizmat e kufës kundër krimit të organizuar dhe emigracionit ilegal, vetëm atëherë mund të hiqen këto kontrolle. Me anë të këtyre masave duhet të qetësoni edhe bashkëqytetarët Tuaj dhe t'i bëni ata të mbështesin idenë e një faze të re të zgjerimit.

FRAKSIONI I BASHKIMIT PËR NJË EVROPË TË KOMBEVE

Fraksioni i Bashkimit për një Evropë të Kombeve e konsideron veten një parti popullore, demokratike dhe liberale të qendrës. Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare në vitin 2004 kjo parti, me 44 deputetët e vet, formoi një prej fraksioneve të vogla por me ndikim në Parlamentin Evropian. 20 prej tyre vinë nga Polonia. Fraksioni shihet si mbrojtës i një Evrope, që mbështet më fort rajonet e veçanta dhe angazhohet fuqishëm për solidaritetin me zonat rurale e të varfra në lëndë të parë të periferisë. Politika e Përbashët Agrare dhe Fondet e Strukturave dhe të Kohezionit konsiderohen prej kësaj partie si arritjet më të rëndësishme të BE-së.

Nën moton „Jo! Shteteve të Bashkuara të Evropës: Po! Evropës së shteteve të bashkuara“ ata kërkojnë të ruajnë pozicionin e shteteve kombëtare brenda Bashkimit Evropian dhe në të njëjtën kohë edhe sovraniteti dhe të qenët i ndryshëm mes tyre. Duhet mbrojtur kulturat dhe gjuhët. Shteteve anëtare duhet t'u mbetet një pjesë e konsiderueshme e pushtetit, dhe BE mundësisht nuk duhet të përzihet në të.

Fraksioni do të dëshironte një Evropë që t'u përgjigjet kryesisht çështjeve me karakter ekonomik dhe teknik duke konsideruar sfidat e mëdha të globalizimit. Nga ana programatike ky fraksion i vë theksin zgjerimit të sigurisë së brendshme përmes ashpërsimit të legjislativës penal në shtetet anëtare (që shkon deri në kërkesën për rivendosjen e dënimit kapital – kërkesë kjo që nuk përputhet me të drejtën e Bashkimit Evropian!). Gjithashtu maxhoranca në Parlamentin Evropian refuzon në mënyrë të qartë kërkesën e këtij fraksioni për një politikë më restriktive kundrejt homosksualëve.

Përsa u përket krizave të herëpashershme në Ballkan fraksioni kërkon një Politikë të Përbashkët të fuqishme në Punët e Jashtme dhe Cështjet e Sigurisë të të gjitha shteteve anëtare të BE-së, politikë e cila zotëron mjetet e nevojshme për të zgjidhur krizat dhe për ta shndërruar Evropën në nivel botëror në një aktor, që duhet marrë seriozisht. Në kontekstin e politikave të brendshme dhe atyre ligjore ky fraksion refuzon njësimin dhe komunitarizimin e mëtejshëm dhe kërkon edhe në këtë drejtim diversitet kombëtar.

UEN mbështet vizionin e ish-Presidentit Francez de Gaulle për një „Evropë të Bashkuar nga Uralet deri në Kaukaz“. Por ky fraksion nuk e ka temë qendrore zgjerimin konkret të BE-së, edhe pse e percepton unionin si të hapur për të gjitha ato vende që mund t'u përgjigjen në mënyrë të plotë kushteve ekonomike të tij.

Detyra Juaj si anëtar i këtij fraksioni

Perfytyroni se jeni anëtar i fraksionit. Për realizimin e interesave Tuaja Ju nevojitet mbështetja e grupimeve të tjera politike, dhe për Ju është tejet e rëndësishme të bëheni të vetëdijshëm që veçanërisht Partia Popullore Evropiane dhe Fraksioni i Partive Socialdemokrate të Evropës luajnë role të rëndësishme në Parlamentin Evropian dhe që në raste të caktuara mund të bllokojnë iniciativat Tuaja, nëse gjen Partnerë më të „vegjël“ koalicioni“.

Kështu varet nga Ju të gjeni të mesmen e duhur. Pasi nga njëra anë Ju duhet të kërkonte kompromisin – që mund të çojnë në detyrën e profilit politik – dhe nga ana tjetër fiksimi në pozicionet Tuaja mund të çojë në një dobësim të ndikimit të Parlamentit Evropian, nëse Ju nuk mund të gjeni gjuhën e përbashkët me kolegët Tuaj. Kjo do ta çonte marrjen e vendimit në duart Komisionit dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Në çdo fraksion ka ekspertë të veçantë për fusha të caktuara politike. Ju bëni pjesë në „Komisionin për Punët e Jashtme“ dhe punoni kryesisht për çështje të strukturimit të ardhshëm të një Bashkimi Evropian në shndërrim dhe zgjerim. Është në dorën Tuaj të kuptoni dhe analizoni mundësitë dhe rreziqet e zgjerimit. Detyra Juaj është të merreni vesh me anëtarët e tjerë të Komisionit për të përfaqësuar një pozicion të përbashkët në lidhje me çështjen e zgjerimit. Më pas do të nisni të kërkoni mbështetës nga fraksionet e tjera, të krijoni koalicione dhe të diskutoni rreth kësaj tematike në mënyrë kontroverse në parlament, në mënyrë që të arrini të bindni kundërshtarët Tuaj politikë për bindjet Tuaja politike. Por jini të vetëdijshëm: Nuk ka kuptim të flisni pa dëgjuar. Në mënyrë që puna e Parlamentit Evropian të jetë efektive duhet të punoni për të arritur një kompromis, me qëllim që të mund të keni sukses edhe në propozimet e Këshillit të BE-së, edhe nëse ato eventualisht nuk përputhen me linjën e Parlamentit Evropian.

Deputetët/et e „Unionit për një Evropë të Kombeve“ nga Letonia në Komisionin e Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian

Integrimi Evropian dhe zgjerimi drejt lindjes – Pozicioni i TB/LNNK

Bashkimi i djathtë konservativ Aleanca për Atdheun dhe Lirinë (Tevzemei un Brivibai Latvijas Nacionalas Neatkarības Kustība [TB/LNNK]) ka mundur të marrë gjatë zgjedhjeve të fundit evropiane pothuaj 30 përqind të votave, pra shumicën e tyre. Kështu katër nga nëntë deputetët letonezë në Parlamentin Evropian vinë nga Aleanca. Kjo aleancë partish është edhe në skenën kombëtare të politikës së brendshme një forcë politike e fuqishme.

Për nga pikëpamja e politikës së brendshme Aleanca ka spikatur për iniciativat armiqësore përkundrejt minoriteteve ruse dhe polake. Kështu me referendumin „Për një Letoni letoneze“ partia synonte të pengonte dhënien e të drejtave minoriteteve ruse, ukrainase dhe polake.

Partia karakterizohet nga një skepticizëm i theksuar përkundrejt Evropës dhe çështjet kombëtare i konsiderojnë më të rëndësishme se të gjitha çështjet evropiane. Për këtë arsye partia mbron idenë për ruajtjen e të drejtave sovraane në fushën e Politikës së Jashtme dhe asaj të Sigurisë. Nga ana e saj nuk dëshirohet një bashkëpunim më i thellë në nivel evropian.

Në fushën e politikave për të drejtën e azilit dhe të refugjatëve partia kërkon pengesa të larta për pranimin e azilkërkuësve. Kështu kjo Aleancë mbështet propozimet për ngritjen e kampeve të azilkërkuësve refugjatë në Ukrainë. Këto iniciativa lidhen ngushtë me një ligj të ashpër mbi azilin, që ka për qëllim reduktimin e numrit të azilkërkuësve dhe të të ashtuquajturve refugjatë të paligjshëm.

Në fushën e politikave për sigurinë dhe mbrojtjen Aleanca pozicionohet kundër krijimit të strukturave konkurruese për NATO-n, duke qenë se këto do ta dobësonin aleancën për mbrojtjen. Strukturat ushtarake evropiane duhen ndërtuar brenda NATO-s.

Lidhur me fazën e re të zgjerimit të BE-së partia e sheh anëtarësimin e Turqisë si problematik. Sipas saj, pranimi i Turqisë nuk duhet mbështetur për motive kulturore si dhe për shkak të një paaftësie kërcënuese të BE-së për të vepruar.

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/e i/e TB/LNNK në fraksionin e Bashkimit Evropian për një Evropë të Kombeve. Juve ju nevojitet mbështetja e grupimeve të tjera politike, për t'i shndërruar pozicionet Tuaja në pozicione të Parlamentit. Për këtë arsye përpiquni që për çështjet tuaja të fitoni mbështetjen e Partisë Popullore Evropiane të përfaqësuar fuqishëm në Parlament.

Në temat që duhen trajtuar brenda Komisionit nënvizoni vazhdimisht dëshirën për pavarësi dhe të qenët kundër pushtetit të tepruar politik në institucionet e BE-së. Për këto çështje përpiquni të siguron mbështetje të tjerët, në mënyrë të veçantë të përfaqësuesit anglezë të partive konservative. Mbështetje të mëtejshme mund të siguron edhe nga deputet konservativë të shteteve të tjera balltike.

Ju deklaroheni hapur kundër anëtarësimin të Turqisë, pasi në gjykimin Tuaj BE-ja është tashmë mjaftueshmërisht e madhe dhe anëtarësimi i Turqisë do të minonte aftësinë e BE-së për të vepruar. Krahas kësaj përmes një anëtarësimi të mundshëm të Turqisë prioritetet do të zhvendoseshin në favor të rajonit të Evropës Juglindore.

Ju nuk jeni kundër aspiratave për anëtarësim të shteteve të Ballkanit (mes të tjerash edhe të Kroacisë) dhe kandidatëve të tjerë të mundshëm nga rajoni për shkak të përvojës së përbashkët të regjimit komunist. Por në të njëjtën kohë nuk shfaqeni si mbështetës i këtyre vendeve. Për Ju kanë rëndësi në radhë të parë aspektet e sigurisë, që do të mund të garantoheshin nga anëtarësimi në BE. Për çdo thellim tjetër të natyrës politike apo institucionale të BE keni qëndrim të qartë refuzues. Po kështu Ju nuk miratoni asnjë marrëveshje reformash të BE-së, që parasheh një integrim të mëtejshëm të BE-së brenda vetes.

FRAKSIONI „TË GJELBËRIT“ NË PARLAMENTIN EVROPIAN (TË GJELBËRIT)

Fraksioni i të Gjelbërve e konsideron veten si forca ekologjike e Parlamentit Evropian. Kjo parti është shumë e re, edhe për shkak të moshës së re të elektoratit të vet, dhe ka formuar gjithmonë një minoritet të vogël në Parlament. Të Gjelbërit morën pjesë në zgjedhjet për Parlamentin Evropian 2004 si e vetmja familje partish evropiane me një program zgjedhor të njësuar, që vlente për të gjitha shtetet anëtare. Në këto zgjedhje të Gjelbërit dolën më të fortë se më parë, dhe tani përfaqësohen nga 40 deputetë, duke përbërë në këtë mënyrë forcën e katërt më të madhe në Parlamentin Evropian.

Mes Partive të Gjelbra të Evropës ekzistojnë pikëpamje dhe koncepte të ndryshme rreth integritimit evropian. Dallimet kryesore qëndrojnë në masën e kalimit të sovranitetit kombëtar mbi Komunitetin.

Por të Gjelbërit evropianë bashkohen në faktin, që bashkimi ekonomik dhe social i rajoneve të Evropës duhet forcuar, modeli social evropian duhet zhvilluar më tej dhe zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë orientuar për nga e ardhmja duhet bërë i detyrueshëm mbi bazë marrëveshjesh, edhe në fushën e bujqësisë.

Të Gjelbërit janë të mendimit, që Bashkimi Evropian e vendos qendrën e veprimtarisë së vet në mënyrë të njëanëshme në interesat ekonomikë. Në të njëjtën kohë atyre u mungon një përcaktim i mjaftueshëm demokratik i institucioneve dhe politikave të Bashkimit Evropian. Leitmotiv i Bashkimit Evropian, sipas tyre, duhet të jenë gjithnjë e më shumë të drejtat e njeriut dhe demokracia. Kjo është arsyeja përse të Gjelbërit në kuadrin e debatit për reformat brenda BE-së janë shprehur gjithmonë pro konsolidimit të qartë të mundësive të bashkëndikimit të Parlamentit Evropian.

Që menjëherë pas përfundimit të konfliktit mes Lindjes dhe Perëndimit të Gjelbërit lidhën kontakte me grupimet përkatëse brenda demokracive të reja në krijim e sipër në shtetet e Evropës Qendore dhe Lindore. Ky fraksion synon integrimin politik të të gjithë Evropës dhe zgjerimin e Komunitetit në një Union politik. Si për inat të zërave kritikues, që dënojnë publikisht një proces zgjerimi shumë më të shpejtë se sa duhet, dhe para së gjithash pasojat e tij ekologjike, të Gjelbërit Evropianë angazhohen për një zgjerim të qëndrueshëm por vërtetë të shpejtë të BE-së.

Në gjykimin e tyre BE duhet të jetë e hapur për të gjitha shtetet evropiane, ku shumica e popullsisë e dëshiron anëtarësimin, në mënyrë që në Evropë të mos vendosen kufij të rinj, që do ta bënin të pamundur paqen e qëndrueshme. Çdo kërkesë anëtarësimi duhet të trajtohet njësoj, pavarësisht nga madhësia, rëndësia strategjike apo stuata ekonomike e vendit përkatës. Kushtet e vetme që duhen vënë janë strukturat demokratike, respektimi i të drejtave sociale dhe kulturore, veçanërisht i të drejtave të minoriteteve dhe dëshira e vetë qytetarëve.

Për të shmangur efektet shokuese mbi situatën ekonomike lokale, duhet që sipas dëshirës të vendosen afate të kufizuara tranzitive, në mënyrë që tregjet të mbrohen njëanshëm. Unioni duhet t'i mbështesë bujarisht vendet candidate dhe duhet, më e pakta, të dyfishojë asistencën në përafrim. Këto fonde do të përdoren në radhë të parë për ngritjen e standardeve sociale dhe ekologjike në vendet candidate si dhe për integrimin me kujdes të këtyre vendeve në tregun e brendshëm. Përmirësimi i standardeve sociale dhe mjedisore është një ndër kërkesat kryesore të të Gjelbërve në kuadër të bisedimeve të anëtarësimit me kandidatët.

Të Gjëlberit janë përpjekur të zhvillojnë opsione veprimi për sfidat e radhës:

- Zgjerimi duhet konsideruar si politika më e efektshme në mbrojtjen nga konfliktet, që mund të jetë hartuar dhe zbatuar ndonjëherë nga BE-ja. Të drejtosh dhe ndikosh procesin e tranzicionit nga diktatura në demokraci dhe nga ekonomia shtetërore në ekonominë e tregut në vendet fqinje të Evropës Qendrore dhe Lindore, kjo është një sfidë historike, rezultati i së cilës duhet parë si histori suksesi për BE-në.
- Vendet e Ballkanit Perëndimor janë një pjesë e rëndësishme e familjes evropiane, ndaj anëtarësimi i tyre në BE është përmbushja e natyrshme e këtij bashkimi.
- Për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore perspektiva e anëtarësimit në BE është shtytje për realizimin e reformave voluminoze, që pa këtë perspektive as nuk do të ishin iniciuar. Si për shtetet e vjetra anëtare ashtu edhe për ato të reja zgjerimi, në masën më të madhe, ka efekte pozitive; e megjithatë situata aktuale brenda 27 shteteve anëtare nuk është e kënaqëshme, sidomos në lidhje me standardet ekonomike dhe sociale për grupet e mëdha në Evropën Qendrore dhe Lindore
- Zgjerimi i Bashkimit Evropian ka kontribuar në përforsimin e rolit të Evropës në botë, por në të njëjtën kohë ka nxjerrë në pah edhe dobësitë, deficitet dhe mangësitë e marrëveshjeve ekzistuese, që e pengojnë BE-në të bëhet aktiv e të veprojë me të gjitha efektet në skenën botërore. Zgjerimet e tjera do të jenë në të mirë të konsolidimit mbarëbotëror të linjës së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, vetëm kur të jenë ndërmarrë reforma shumë të thella, qendra e të cilave duhet të jetë para së gjithash mbrojtja nga konfliktet.
- Kriteret e fiksuar në Kopenhagen në vitin 1993 përbëjnë për të Gjëlberit njësitë matëse të pjekurisë së kandidatëve për anëtarësim në BE. Këto kritere janë të panegociueshme. Detyrimi për përmbushjen e të gjitha kriterëve politike nuk përfundon me anëtarësimin. Prej këtej duhet të vihet në përорim një mekanizëm, me anë të të cilit të mund të verifikohet rregullisht dhe nga të gjitha shtetet anëtare, nga të vjetrat njësoj si nga të rejat, respektimi i parimeve bazë të BE-së – lirisë, demokracisë, të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe shtetit ligjor (neni 6 i Marrëveshjes mbi BE-në).
- Parlamenti Evropian luan një rol shumë të rëndësishëm në monitorimin e respektimit të kriterëve të anëtarësimit nga shtetet candidate.
- BE u është përmbajtur me të drejtë detyrimeve të veta karshi Kroacisë dhe Turqisë. Hapja e bisedimeve të anëtarësimit me këto dy vende do të mirëpritej. Por megjithë këtë qëndrim përgjithësisht mbështetës, të Gjëlberit gjithmonë kanë bërë të qartë, se ku qëndrojnë mangësitë e reformave në këto vende, sipas gjykimit të tyre. Të Gjëlberit duan, që të bëjnë pjesë edhe në të ardhmen në mbështetësit optimistë por kritikë të anëtarësimit të këtyre dy vendeve. Procesi i bisedimeve të anëtarësimit në thelb nuk e ka të pëcaktuar rezultatin, por objektivi i vetëm është gjithsesi anëtarësimi.
- Perspektiva evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojë të ruhet, pasi stabiliteti dhe paqja në Ballkan për BE-në e viteve të ardhshme duhet të kenë prioritetin absolut. Niveli i bashkëpunimit rajonal mes vendeve të Ballkant Perëndimor përben një indikator domethënës të pjekurisë së tyre për anëtarësimin në BE, por në fund secili vend do të gjykohet sipas stadardeve të arrira prej tij dhe anëtarësimi i tij do të negociohet pikërisht mbi bazën e një kalendari individual.
- Për Unionin aktual, por edhe si kusht për zgjerimet e ardhshme, janë të nevojshme reforma të thella. Këto duhet domosdoshmërisht të përmbajnë arritjet qendrore të projektkushtetutës dhe detyrimin ligjor me Kartën e të Drejtave Themelore.
- Pa vendosur kufijtë përfundimtarë të Bashkimit Evropian të Gjëlberit bëhen të vetëdijshëm, që me hapjen e bisedimeve dhe anëtarësimin e mundshëm të Turqisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor dekadën e ardhshme aftësia integruese e Unionit do të cekë kufijtë e saj. Integrimi i vendeve të tjera do të jetë sfida e madhe

për BE-në. Për këtë arsye deri në atë moment, duke qenë se që tani mund të gjykohe efektet e bisedimeve aktuale dhe të anëtarësimeve të mundshme, Komuniteti nuk duhet në asnjë mënyrë t'i ofrojë perspektivën e anëtarësimit një vendi tjetër.

Detyra Juaj si anëtar i fraksionit

Përfytyroni, se jeni anëtar i fraksionit. Ju keni nevojë për mbështetjen e grupimeve të tjera politike që pozicionet Tuaja të mund t'i sillni si pozicione të Parlamentit Evropian në procesin e zgjerimit. Për Ju është tejet e rëndësishme të bëheni të vetëdijshëm që veçanërisht Partia Popullore Evropiane luan një rol të rëndësishëm në Parlamentin Evropian dhe që në raste të caktuara mund të bllokojë iniciativat Tuaja, nëse gjen partnerë koalicioni. Kështu varet nga Ju të gjeni të mesmen e duhur. Pasi nga njëra anë Ju duhet të kërkoni kompromisin – që mund të çojnë në detyrën e profilit politik – dhe nga ana tjetër fiksimi në pozicionet Tuaja mund të çojë në një dobësim të ndikimit të Parlamentit Evropian, nëse Ju nuk mund të gjeni gjuhën e përbashkët me kolegët Tuaj. Kjo do ta çonte marrjen e vendimit në duart Komisionit dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Në çdo fraksion ka ekspertë të veçantë për fusha të caktuara politike. Ju bëni pjesë në „Komisionin për Punët e Jashtme“ dhe punoni kryesisht për çështje të strukturimit të ardhshëm të një Bashkimi Evropian në shndërrim dhe zgjerim. Është në dorën Tuaj të kuptoni dhe analizoni në mënyrë kritike mundësitë dhe rreziqet e zgjerimit.

Detyra Juaj është të merreni vesh me anëtarët e tjerë të Komisionit për të përfaqësuar një pozicion të përbashkët në lidhje me çështjen e zgjerimit. Më pas do të nisni të kërkoni mbështetës nga fraksionet e tjera, të krijoni koalicione dhe të diskutoni rreth kësaj tematike në mënyrë kontroverze në parlament, në mënyrë që të arrini të bindni kundërshtarët Tuaj politikë për bindjet Tuaja politike. Por jini të vetëdijshëm: Nuk ka kuptim të flisni pa dëgjuar. Në mënyrë që puna e Parlamentit Evropian të jetë efektive duhet të punoni për të arritur një kompromis, me qëllim që të mund të keni sukses edhe në propozimet e Këshillit të BE-së, edhe nëse ato eventualisht nuk përputhen me linjën e Parlamentit Evropian.

Deputet/e i/e „Të Gjelbërve“ në komisionin e Jashtëm të PE nga Austria

www.gruene.at

Austria dhe BE – pozicioni i të Gjelbërve

Për shkak të pozicionit të neutralitetit Austria ka qenë për një kohë të gjatë skeptike ndaj anëtarësimit në BE. Pas ndërrimit të kursit politik, në vitin 1995 u realizua anëtarësimi i Austrisë në BE, akt ky që gjeti miratimin e shumicës së popullsisë austriake. Që prej fillimit të anëtarësisë së saj Austria sinjalizoi, që dëshironte të bënte pjesë në bërthamën e fortë të Bashkimit Evropian. Kështu për shembull ajo nënshkroi Marrëveshjen e Schengen-it në të cilën rregullohej heqja graduale e kontrollit të personave në kufijtë e brendshëm të shteteve nënshkruese të Marrëveshjes. Megjithë neutralitetin në politikën e saj të jashtme që prej Luftës së Dytë Botërore Austria jep kontributin dhe bashkëpunimin e vet në BE edhe në Politikën e Përbashkët për Punët e Jashtme dhe të Sigurisë.

Partia e Gjelbër e Austrisë ka refuzuar për një kohë të gjatë anëtarësimin e Austrisë në BE, pasi e konsideronte neutralitetin e këtij vendi si më të rëndësishëm sesa anëtarësimin në BE. Prej disa kohësh ky pozicion ka ndryshuar dhe Partia e Gjelbër angazhohet për një politikë evropiane dhe BE. Në Parlamentin Evropian të Gjelbërit kanë 40 vende, dhe austriakët përfaqësohen me dy prej tyre.

Të Gjelbërit dhe zgjerimi

Të Gjelbërit e shohin zgjerimin e BE si një mundësi për të kapërcyer ndarjen e Evropës, nacionalizmat dhe ndasitë mes një Evrope të pasur dhe të varfër, gjithnjë nëse ky zgjerim ndodh nën respektimin e plotë të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore. Zgjerimi nuk duhet keqpërdorur për qëllime të polemikave nacionaliste. Zgjerimi mund të jetë i suksesshëm, nëse është një projekt social dhe nëse qëndron mbi themele ekologjike.

Të Gjelbërit kërkojnë përtej kësaj një strategji të përgjithshme për përafrimin e Evropës Juglindore me BE, e cila duhet të garantojë për të gjitha shtetet një akses të barabartë dhe të qartë në fondet mbështetëse të BE – nuk ka rëndësi nëse e keni tanimë statusin e kandidatit apo jo. Për më tej kërkohet heqja e vizave për të gjithë banorët e Ballkanit Perëndimor – që në vitet '80 banorët e Jugosllavisë nuk kishin nevojë për leje-hyrjeje.

Meqenëse zgjerimi në drejtim të Lindjes përkrahet tashmë nga të Gjelbërit, ata janë pozitivë edhe kundrejt zgjerimit të planifikuar me Kroacinë. Me këtë vend, sikurse edhe me vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, Austria ka marrëdhënie shumë të ngushta për shkak të pozitës gjeografike. Zgjerimi përbën për Partinë e Gjelbër një shans historik për kapërcimin e ndarjes së Evropës, ndaj kjo parti angazhohet në mënyrë aktive për një anëtarësim të shpejtë të vendeve kandidatë në BE si dhe është kundër afateve të ngurta të tranzicionit.

Në Këshillin Kombëtar Të Gjelbërit votuan për dërgimin e trupave në kuadër të misionit EULEX (Kosovë). Përs i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës, kjo për ta nuk ishte shumë e ngutshme. Austria nuk duhet të jetë pararendës në këtë aspekt, dhe para marrjes së një vendimi përfundimtar duhet të vlerësohet stabiliteti në Kosovë dhe rajonet

fqinje, baza sipas të drejtës ndërkombëtare, mbrojtja e minoriteteve. Të Gjëlberit ishin partia e vetme në Këshillin Kombëtar, që është shprehur qartazi përpara Këshillit Evropian më 16-17 dhjetor 2004 për hapjen e bisedimeve me Turqinë. Ky është një qëndrim që po vazhdon të mbahet, e megjithatë gjendja në Turqi mbahet nën mbikqyrje të rreptë.

Sipas të Gjëlberve bashkimi i Evropës nuk qëndron mbi kritere të tilla si besimet fetare apo origjina etnike, por vetëm dhe vetëm në demokraci dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye të Gjëlbrit e konsiderojnë zbatimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe demokracisë si kushte të domosdoshme për anëtarësimin në BE.

Qëllimi i të Gjëlberve është shndërrimi i BE në një komunitet social, ekologjik dhe demokratik shtetesh, i cili mund të luajë rolin e vet në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Taktika:

Ju bëni pjesë në përkrahësit e zgjerimit të BE. Anëtarësimi i Kroacisë për Ju është i vetëkuptueshëm, pasi prej kohësh vendi Juaj ka marrëdhënie të mira në këtë vend, veçanërisht në aspektin ekonomik. Gjithashtu Ju angazhoheni fort edhe për Maqedoninë. Krahas kësaj Ju punoni për një Evropë të madhe, e cila duhet të kalojë kufijtë e BE së deritanishme. Ndaj në këtë kontekst Ju përkrahni anëtarësimin e Turqisë, pasi në vlerësimin Tuaj në themel të BE nuk duhet të qëndrojnë kritere të tilla si besim i njëjtë fetar, gjuhë apo një sfond i përbashkët kulturor dhe etnik, por demokracia dhe të drejtat e njeriut. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe demokracisë për Ju janë vlera qendrore dhe kushte paraprake për anëtarësimin. Shtetet candidate, para së gjithash Turqia, duhet të përmbushin fillimisht këto kushte, në mënyrë që Ju më pas të jepni miratimin Tuaj për anëtarësimin në parim.

Qëllime të tjera për Ju janë demokratizimi i BE dhe politika mjedisore. Ndaj edhe Ju kërkoni një politikë reformash dhe strukturash me perspektivën e qëndrueshmërisë. Kushtojini rëndësi të veçantë faktit që vendet candidate duhet të përmirësojnë strukturat e tyre nukleare. Veç kësaj ngrini një pikë kontakti për të mundësuar përcjelljen e interesave të vendeve candidate në Parlamentin Evropian.

Gjatë bisedimeve vendeve candidate duhet t'u jepet një ndihmë e konsiderueshme – para së gjithash në aspektin e mbrojtjes së natyrës (fjala kyç: mbrojtje nga reaktorët). Në „këmbim“ të kësaj Ju prisni respektimin e qartë të të drejtave të njeriut dhe garantimin e mbrojtjes së pakicave në vendet që synojnë anëtarësimin. Kontaktoni edhe me parti të tjera, që janë pozitive kundrejt zgjerimit, dhe përpiquni të konceptoni pozicione dhe strategji të përbashkëta.

Deputetët/et nga Belgjika të fraksionit të të „Gjelbërve“ në Komisionin e Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian

www.ecolo.be

Integrimi Evropian dhe zgjerimi në drejtim të Lindjes – Pozicioni i ekologjistëve

Në panoramën partiake të Belgjikës nuk ka parti kombëtare, duke qenë se tre familjet partiake të mëdha aktuale janë organizuar në mënyrë të pavarur në tre rajone të Belgjikës (Flandria, Valonia dhe Brukseli) dhe që natyrisht në lidhje me tema të caktuara politike përfaqësojnë pozicione pjesërisht të ndryshme. Secila familje partiake ka një parti në zonën e Flandrisë dhe të Valonisë, në kryeqytetin Bruksel janë të përfaqësuara të gjitha partitë.

Vitet e fundit Belgjika ka përcjellur një debat intensiv në lidhje me të ardhmen e Bashkimit Evropian. Nga zgjedhjet për në Parlamentin belg dhe në atë Evropian militantët e grupimit radikal Vlaams Block, që shprehen për forcimin e rajonit dhe vënë në pikëpyetje sukseset e derimëtanishme të procesit të Bashkimit Evropian, morën më shumë se dhjetë përqind të votave dhe dolën së andejmi në një pozicion më të fortë. Veç këtij grupimi radikal në Flandri dhe pendantit të tyre politikisht të parëndësishëm në Valoni, partitë e tjera belge janë mbështetëse të procesit të bashkimit evropian.

Kështu ECOLO, Partia e Gjelbër e pjesës frankofone të Belgjikës, në thelb e mbështet procesin e bashkimit evropian dhe angazhohet vecanërisht për konsolidimin e parimeve dhe projekteve ekologjike dhe sociale. Evropa duhet të bëhet një fuqi udhëheqëse në mbrojtjen e mjedisit dhe në vendosjen e drejtësisë sociale. Në këtë kontekst partia i vë theksin vecanërisht parimit të qëndrueshmërisë ekologjike, sociale dhe ekonomike dhe kërkon një politikë evropiane afatgjatë. Barazia e shanseve për të gjitha grupet e popullsisë dhe integrimi i minoriteteve në shoqëri bëjnë pjesë në çështjet kryesore të të Gjelbërve.

ECOLO u themelua në mars 1980 dhe ishte një ndër partitë e para të gjelbra që hynë në një parlament kombëtar në vitin 1981. Në zgjedhjet e vitit 1981 ECOLO mori pesë përqind të votave, pra pesë vende, prej të cilave dy në Dhomën e përfaqësuesve dhe tre në SENAT. Që prej zgjedhjeve parlamentare të vitit 2003 ECOLO nuk bën më pjesë në qeverinë belge.

ECOLO ka dërguar një deputet në Parlamentin Evropian, edhe partia simotër e Flandrisë Groen! (emri i mëparshëm: Agalev) përfaqësohet me një vend. Belgjika ka gjithsej 24 vende në Parlamentin Evropian.

Ekologjistët përshëndesin hapat e ndërmarra deri më tani në Turqi në kuadër të reformave dhe mbështesin hapjen e negociatave. Turqia sipas tyre duhet trajtuar me të njëjtat kritere anëtarësimi sikurse edhe të gjithë kandidatët e tjerë. Gjithsesi ECOLO kërkon prej qeverisë turke plotësimin e mangësive të Kriterëve të Kopenhagenit, vecanërisht në fushën e të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së minoriteteve.

ECOLO deklarohej, sikurse edhe partitë e tjera të gjelbëra në nivel evropian, për integrimin e vendeve të Ballkanit në Bashkimin Evropian, për sa kohë që këto vende do të respektojnë kriteret, që kanë vlejtur përkatësisht vazhdojnë të vlejné edhe për ish-vendet kandidate apo për kandidatët e ardhshëm (veçanërisht harmonizimi i të drejtave të njeriut me zhvillimin e shtetit ligjor). Në lidhje me mundësinë që projekti evropian të

shtrihet edhe në shtete të tjera, ECOLO e konsideron të domosdoshme hapjen e një debati publik evropian rreth kufijve të BE-së dhe llojin e këtij projekti.

Në mënyrë të përgjithshme edhe qeveritë, në këndvështrimin e ekologjistëve, duhet të marrin seriozisht përgjegjësitë e tyre lidhur me fazat aktuale apo ato të ardhshme të zgjerimit: duhet mbajtur një kurs konsekuent, në mënyrë të veçantë nga ana financiare, dhe solidar, me qëllim që të arrihet një integrim më i mirë i anëtarëve të rinj dhe të ardhshëm si dhe të pengohet ekuilibri brenda BE-së. Në këtë kontekst ato e konsiderojnë të pakuptimtë tendencën aktuale për të zvogëluar kontributin e qeverive kombëtare, ndërsa një buxhet edhe më të madh evropian, të mbajtur nga fonde të vetat, e cilësojnë si të domosdoshëm për funksionimin e mirë të BE-së dhe për realizimin e objektivave të saj.

Taktika:

Ju si deputet/e e ECOLO-a në Parlamentin Evropian keni rezervat Tuaja përkundrejt një pranimi të shpejtë të anëtarëve të rinj, megjithë mbështetjen e gjerë të programit të fraksionit të të Gjerlbërve për zgjerimin e BE-së, dhe kjo pasi niveli i integritit brenda Komunitetit tanimë të përbërë nga 27 shtete do të ulej sipas mendimit Tuaj në mënyrë të pashmangshme .

Në të njëjtën kohë Ju kujtoni, që edhe popullsia belge ka nevojë për kohë, që të mbështesë Bashkimin Evropian si një strukturë të nevojshme dhe të shohë avantzhe afatgjata. Veprime të nxituara do të çonin në forcimin e grupeve të djathta, dhe jo vetëm në Belgjikë.

Ju preferoni një mbështetje të gjerë të reformave politike, ekonomike, sociale dhe ekologjike, që do të çonin në një adaptim gradual të të tërë inventarit ligjor të përbashkët të BE-së në shtetet candidate për anëtarësim.

Edhe çështja e performancës institucionale të BE-së dhe të reformave që lidhen me të është e rëndësishme për Ju. Në këtë drejtim Ju kërkonit zgjerimin e parimeve sociale dhe ekologjike të BE-së.

Në mbyllje Ju sillni në vëmendje, që zgjerimi i BE-së – vecanërisht me Turqinë – bën të nevojshëm një sforcim të madh financiar të të gjitha vendeve anëtare. Një zgjerim pa siguruar më parë çështjen financiare do të ishte i pamundur.

Deputetët/et e „gjelbër„ të Francës në Komisionin e Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian

Franca dhe integrimi evropian – Pozicioni i Les verts

Franca bën pjesë në bashkëthemeluesit e Integritit evropian, ku kapërcimi i armiqësisë disavjeçare me vendin fqinj, Gjermaninë, dhe ndërtimi i një marrëdhënieje në mirëbesim mes dy vendeve kanë qenë gjithmonë ndër forcat lëvizëse të procesit të bashkimit evropian. Që nga themelimi i Komunitetit Evropian për Qymyrin dhe Çelikut në vitin 1951 e deri më sot të gjithë hapat vendimtarë të integritit e kanë pikënisjen në unifikimin e motorit gjermano-francez.

Edhe Të Gjelbërit francezë, krijuar në vitin 1984, Les Verts, e mbështesin bashkimin evropian dhe synojnë ta çojnë atë edhe më përpara. Por gjithsesi partia dëshiron të vendosë këtu theksin në pika të caktuara, që nuk orientohen vetëm për nga kriteret ekonomike por edhe nga ato ekologjike, sociale dhe demokratike.

Les Verts janë kundër një liberalizimi ekonomik të ekzagjeruar dhe angazhohen për një Evropë me një zhvillim ekologjik të qëndrueshëm. Ata mbrojnë idenë e një kushtetute me elemente demokratike, ku qytetari të dëgjohet më shumë, si dhe krijimin e një sistemi me dy dhoma: Parlamentin Evropian dhe Senatin e Kombeve dhe Rajoneve.

Kështu fushat e politikave mjedisore, sociale, të mbrojtjes së konsumatorit dhe të zhvillimit janë tema të rëndësishme për këtë parti. Për të krijuar një Evropë të paqte, të hapur dhe të gjithëve partia Les Verts, në vend të krijimit të një superfuqie evropiane me armë bërthamore, kërkojnë një zhvillim gjithnjë e më demokratik dhe ekologjik brenda Bashkimit Evropian dhe shteteve të tyre fqinje.

Në Parlamentin Evropian Les Verts përbëjnë gjashtë nga 78 deputetët francezë.

Les Verts dhe zgjerimi

Les Verts pozicionohet pozitivisht përkundrejt një zgjerimi të ri BE-së. Kjo parti mendon se të qenit dakord me procesin e zgjerimit duhet të demonstronhet edhe materialisht, ndaj dhe kërkon si nga qeveria franceze ashtu edhe nga BE mbështetje të mëtejshme logjistike për vendet kandidate për anëtarësim, si p.sh. përmes kualifikimit të nëpunësve në vendet kandidate.

Franca ka mbështetur për kohë të gjatë hapjen e bisedimeve të anëtarësimit në rastin e veçantë të Turqisë, edhe pse qeveria konservative dhe Presidenti Sarkozy aktualisht reagojnë edhe me më shumë rezerva rreth kësaj çështjeje. Duke qenë se edhe skepticizmi i popullsisë franceze në lidhje me anëtarësimin e Turqisë është gjithnjë e në rritje, qeveria e ka relativizuar lehtë qëndrimin e saj pozitiv. Les Verts megjithatë mbështesin plotësisht hapjen e bisedimeve me Turqinë dhe kërkojnë që premtimet e dhëna kohë më parë tani të mbahen. Në vend që të ushqehen vazhdimisht frika dhe dyshimet përkundrejt Turqisë, duhen nxjerrë më në pah epërsitë e gjithanshme të një anëtarësimi të saj. Sipas të Gjelbërve francezë del nevoja e një fushate të gjerë informimi, me qëllim që Turqia të bëhet më e njohur mes njerëzve si dhe të evidentohet roli i saj për Evropën në të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Në këtë mënyrë mund të bëhet për vete edhe popullsia në rastin e anëtarësimit të nevojshëm të Turqisë.

Në përgjithësi Les verts dëshirojnë të arrijnë lidhjen e zgjerimit me thellimin. Kjo do të thotë, që institucionet dhe strukturat e BE-së duhen reformuar dhe t'i përshtaten një Evropë më të madhe. Për këtë i duhet vënë theksi në mënyrë të veçantë idesë së demokracisë bazë dhe duhet përforcuar Parlamenti Evropian.

Taktika:

Përsa u përket çështjeve të zgjerimit: si deputet/e i/e Parlamentit Evropian Ju përfaqësoni në thelb pozicionin e e përbashkët të Partisë së Gjellbër Evropiane, në përcaktimin e të cilit keni kontribuar edhe Ju vetë. Si bashkëpunëtor disavjeçar i *amnesty international* keni krijuar kontakte të mira me grupet e të drejtave të njeriut në Turqi.

Ndaj – krahas integritetit të shteteve të Ballkanit – Ju angazhoheni në mënyrë të veçantë edhe për një integrim afatgjatë të Turqisë në Bashkimin Evropian. Në gjykimin Tuaj nuk ka dallime civilizimi mes BE-së dhe Turqisë, që do të justifikonin moskonsiderimin e këtij vendi në krahasim me kandidatët e tjerë. Edhe nga pikëpamja gjeografike nuk mund të vihet një kufi i qartë, i cili do ta përjashtonte Turqinë nga anëtarësimi. Dhe në mbyllje, ky vend luan në Ligën Evropiane të Kampionëve, konkuron në European Song Contest dhe është që prej 60 vjetësh anëtar i Këshillit të Evropës, dhe kjo nuk ka përbërë shqetësim për njeri.

Anëtarësimi i Turqisë do të sillte avantazhe për të gjitha palët: më shumë siguri në të gjithë kontinentin, një treg të brendshëm edhe më të madh dhe, jo më pak e rëndësishme, shansin e madh për të detyruar Turqinë në respektimin e standardeve të larta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në mbrojtjen e mjedisit dhe në integrimin e minoriteteve si dhe për ta mbështetur atë në zhvillimin drejt një shteti modern. Kjo do të ishte në gjykimin Tuaj një shembull i suksesshëm i globalizimit solidar, që do t'i jepte kuptim angazhimit të shumë gjeneratave evropianësh.

Ju e konsideroni anëtarësimin pas plotësimit të kushteve të përcaktuara qartë, si mundësi të vetme për të ushtruar presion mbi qeverinë turke që reformat – veçanërisht ato në fushën e të drejtave të njeriut - të mund të bëjnë përpara dhe të realizohen në mënyrë të suksesshme. Përpiquni që me mbështetjen e parlamentarëve dhe fraksioneve të tjera të ndikohet në daljen e një vendimi ligjor për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në Turqi. Mbi këtë bazë mund të hapen më pas bisedimet për anëtarësim.

FRAKSIONI I „TË MAJTËS SË BASHKUAR EVROPIANE / TË TË GJELBËRVE TË VERIUT“ (GUE/NGL)

E Majta e Bashkuar Evropiane / Të gjelbrit e Veriut janë një grupim socialisto-komunist brenda Parlamentit Evropian. Ajo është themeluar në vitin 1989 nga partitë komuniste franceze, greke, spanjolle dhe portugeze. Për çdo anëtarësim të ri të Bashkimit Evropian parti të vendeve të reja anëtare aderonin në këtë grupim të lidhur çlirët, i cili e sheh veten si forum të pikëpamjeve shpesh shumë të ndryshueshme të partive kombëtare, që e formojnë atë.

Partitë e të majtës së spektrit politik të shteteve të ndryshme anëtare u lidhën me partitë komuniste të jugut duke krijuar fraksionin e pestë më të madh të Parlamentit Evropian. Partitë më të mëdha të këtij grupimi janë partia gjermane DIE LINKE dhe komunistët italianë.

Shumica e këtij grupimi partiak kërkon demokratizimin e mëtejshëm institucioneve të Bashkimit Evropian si dhe progresin e integritimit. Por ata i kundërvihen politikës neoliberalë për ekonominë dhe financat e BE-së. Në prioritetet e këtij fraksioni bëjnë pjesë lufta kundër papunësisë, veçanërisht në vendet e reja anëtare, dhe mbrojtja e mjedisit. Një politikë e përmirësuar për zhvillimin dhe dhënien e asistencës si dhe mbrojtja e refugjatëve politikë dhe ekonomikë janë tema të rëndësishme për të gjitha partitë anëtare të GUE/NGL. Në vlerësimin e këtyre partive BE duhet të krijohet dhe të kultivohet një klimë sociale, që të garantojë të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

Mungesa e stabilitetit, një përqendrim i ekzagjeruar i pushtetit, migrimi për motive ekonomike dhe racizmi mund të luftohen vetëm përmes një demokratizimi të mëtejshëm të Bashkimit Evropian. Ato i kundërvihen politikës aktuale të euro-përqendruar të BE-së, që e konsiderojnë si arsye për pabarazinë e vazhdueshme. Ato kërkojnë zgjerimin e zonës së stabilitetit dhe mirëqenies, ose duke pranuar shtete të reja anëtare, ose duke lidhur partneritete të privilegjuara me shtete periferike.

Fakti që në GUE/NGL bëjnë pjesë edhe parti me qëndrime tejet armiqësore kundrejt Evropës, që e konsiderojnë BE-në si një konstruksion pushteti kapitalisto-imperialist, tregon në mënyrë shumë të qartë se sa e larmimshme dhe pjesërisht kontradiktore janë pikëpamjet brenda kësaj aleance partiake.

Megjithatë në tërësi fraksioni mbështet anëtarësimet e reja në Bashkimin Evropian. Veç Turqisë dhe Kroacisë fraksioni mbështet me forcë të veçantë edhe anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE. Debati mes Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë për emrin e vendit, në gjykimin e këtij fraksioni, është një çështje që duhet zgjidhur shpejt. Në këtë proces zgjidhjeje duhet të marrë pjesë edhe Parlamenti Evropian. Vënia e Vetos nga ana e Greqisë në lidhje me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE do të kishte pasoja të gjera për të gjithë Unionin – dhe jo vetëm për të dy shtetet e prekura.

Detyra Juaj si anëtar i fraksionit

Perfytëroni se jeni anëtar i fraksionit. Për realizimin e interesave Tuaja Ju nevojitet mbështetja e grupimeve të tjera politike, dhe për Ju është tejet e rëndësishme të bëheni të vetëdijshëm, që veçanërisht Partia Popullore Evropiane dhe Fraksioni i Partive Socialdemokrate të Evropës luajnë role të rëndësishme në Parlamentin Evropian dhe që në raste të caktuara mund të bllokojnë iniciativat Tuaja, nëse gjeni partnerë më të „vegjël“ koalicioni.

Kështu varet nga Ju të gjeni të mesmen e duhur. Pasi nga njëra anë Ju duhet të kërkoni kompromisin – që mund të shndërrohet në detyrën e profilit politik – dhe nga ana tjetër fiksimi në pozicionet Tuaja mund të çojë në një dobësim të ndikimit të Parlamentit Evropian, nëse Ju nuk mund të gjeni gjuhën e përbashkët me kolegët Tuaj. Kjo do ta çonte marrjen e vendimit në duart Komisionit dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Në çdo fraksion ka ekspertë të veçantë për fusha të caktuara politike. Ju bëni pjesë në „Komisionin për Punët e Jashtme“ dhe punoni kryesisht për çështje të strukturimit të ardhshëm të një Bashkimi Evropian në shndërrim dhe zgjerim. Është në dorën Tuaj të kuptoni dhe analizoni mundësitë dhe rreziqet e zgjerimit. Detyra Juaj është të merreni vesh me anëtarët e tjerë të Komisionit për të përfaqësuar një pozicion të përbashkët në lidhje me çështjen e zgjerimit. Më pas do të nisni të kërkoni mbështetës nga fraksionet e tjera, të krijoni koalicione dhe të diskutoni rreth kësaj tematike në mënyrë kontroverze në parlament, në mënyrë që të arrini të bindni kundërshtarët Tuaj politikë për bindjet Tuaja politike. Por jini të vetëdijshëm: Nuk ka kuptim të flisni pa dëgjuar. Në mënyrë që puna e Parlamentit Evropian të jetë efektive duhet të punoni për të arritur një kompromis, me qëllim që të mund të keni sukses edhe në propozimet e Këshillit të BE-së, edhe nëse ato eventualisht nuk përputhen me linjën e Parlamentit Evropian.

Deputetët/et e „Të Majtës së Bashkuar Evropiane“ nga Republika Çeke në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Republika Çeke dhe Bashkimi Evropian – Pozicioni i KSČM

Republika Çeke është bërë që prej datës 1 maj 2004 anëtare e Bashkimit Evropian. Së bashku me Çekinë atë ditë u anëtarësuan edhe nëntë vende të tjera nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Në këtë mënyrë u realizua rrethi më i madh dhe më i vështirë i zgjerimit të Bashkimit / Komunitetit Evropian – BE deri atëherë me 15 shtete anëtare u shtua me nëntë anëtarë të rinj.

Me anëtarësimin në BE u përmbush një prej çështjeve më të rëndësishme të politikës së jashtme çeke që prej ndërrimit të sistemit në fund të viteve tetëdhjetë. Qëllimi i qeverisë së orientuar për nga qendra e majtë është tanimë pjesëmarrja aktive dhe konstruktive në punën e përditshme për integrimin evropian, ku duhet ruajtur dhe mbajtur në konsideratë gjithmonë interesi kombëtar çek.

Komunistická strana Čech a Moravy (KSČM, Partia Komuniste e Böhmen dhe Mähren), me orientim qartësisht të majtë, është që prej vitit 1990 organizata pasuese e Partisë Komuniste të Çekosllovakisë. Kjo parti qeverisi në mënyrë të pakufizuar për një periudhë më shumë se 40 vjeçare në ish-Çekosllovakinë komuniste.

KSČM ka patur deri më sot një elektorat fiks të qëndrueshëm, para së gjithash në brezin e vjetër. Pas disa vitesh të vështira në fillim të viteve nëntëdhjetë KSČM nisi të rifitonte peshë dhe tani është partia e tretë më e fuqishme në Parlamentin Çek. Opinioni publik çek fillimisht u zhgënjye nga politika e qeverisë, e cila ishte e orientuar së pari djathtas dhe më pas majtas, dhe pjesëmarrja në zgjedhje ra dukshëm. Kjo bëri që KSČM komuniste të merrte me shumë mbështetje opozitare – së bashku me numrin e elektoratit të qëndrueshëm komunist. Rezultatet më të mira KSČM i arriti në zgjedhjet e para evropiane në qershor 2004. Duke marrë 20% komunistët u bënë në mënyrë befasuese partia e dytë më e fortë në vend dhe u përfaqësuan në Parlamentin Evropian me gjashtë deputetë. Këta deputetë renditen në fraksionin konfederal të të Majtës së Bashkuar Evropiane / të të Majtëve të Gjellbër të Veriut.

Qëndrimi i KSČM përkundëjt BE-së ka qenë gjithsesi i tërhequr në 15 vitet e fundit. Sot komunistët nuk është se e refuzojnë procesin e integritit në tërësi, por forma aktuale dhe orientimi i këtij procesi është për ta i papranueshëm. Kjo u bë e qartë edhe me referendumin kombëtar për anëtarësimin e Çekisë në BE – KSČM atëherë u kishte rekomanduar zgjedhësve të vet një refuzim të qartë të tij. Krahas kushteve të negociuara keq për anëtarësimin e Çekisë, nga komunistët opozicionarë kritikohen kryesisht diktati i ekzagjeruar dhe i pandershëm i BE-së nga Brukseli si dhe burokracia në rritje dhe kuadri ligjor komunal tejet i paqartë dhe i ngushtë për qytetarët dhe qytetaret.

Në thelb kjo parti kërkon:

1. Një Evropë, që percepton përgjegjësinë për paqen në botë: pa dërgim trupash evropiane si dhe të ngrihet zyra për çarmatimin dhe kontrollin e eksportit të armëve.
2. Një Evropë, ku punësimi i plotë dhe solidariteti social të kenë përparësi: më shumë investime, respektim dhe vënie në zbatim e parimit të shtetit social, në vend të fiksimit në një rend ekonomik neoliberal, vënia në zbatim e konceptit të pagave minimale evropiane dhe harmonizimi i taksave në vend të dumping-ut social dhe tatimor në shtete të caktuara.

3. Një Evropë demokratike: më shumë të drejta për Parlamentin Evropian, më shumë demokraci të drejtpërdrejtë, zbatim të parimit të ndarjes së pushteteve në nivel evropian, garantim i të drejtës për grevë.
4. Një Evropë që mbështetet në luftën kundër nacionalizmit, antisemitizmit, racizmit dhe në hapjen ndaj botës, tolerancën dhe demokracinë.

KSČM dhe faza e ardhshme e zgjerimit

Duke iu referuar një faze eventuale të zgjerimit në të ardhmen KSČM ka një qëndrim shumë pozitiv përse i përket Turqisë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. Komunistët janë të gatshëm të mbështesin në mënyrë aktive këtë fazë zgjerimi, duke qenë se ajo përputhet me objektivat e partisë së tyre: mbështetjen e asaj politike në Evropë, që bazohet në parimet e partneritetit, bashkëpunimit dhe koordinimit reciprok mes shteteve të veçanta. Një fazë zgjerimi e përgatitur mirë mund të jetë një hap në rrugën e duhur drejt një kontinenti të përbashkët evropian.

Taktika:

Sie dputet/e çek/e i/e KSČM në fraksionin e të Majtës së Bashkuar Evropiane / të Majtës së Gjellbër të Veriut Ju angazhoheni brenda Parlamentit Evropian në mënyrë aktive për anëtarësimin në BE të vendeve të Evropës Juglindore, por vetëm pasi të jenë përmbushur disa kushte të caktuara. Çdo fazë zgjerimi mund të realizohet vetëm mbi bazën e plotësimin të Kriterëve të Kopenhagenit, dhe çdo kandidat eventual për anëtarësim duhet të jetë i përgatitur për anëtarësimin në mënyrë mjaft të hollësishme në pikëpamje ekonomike dhe politike. Shumë të rëndësishme për mbështetjen janë para së gjithash gatishmëria dhe stabiliteti ekonomik i kandidatëve.

Ju i ndiqni me kujdes kriteret politike, veçanërisht në rastin e Turqisë, duke qenë se atje të drejtat e njeriut – megjithë përmirësimet e shënuara - vazhdojnë të mos respektohen në masë të plotë.

Në vendet kandidatë për anëtarësim si Turqia dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor duhen sqaruar ende – sipas mendimit Tuaj – çështjet rreth pozicionit dhe të drejtave të minoriteteve përkatëse (p.sh. kurdë, serbë, shqiptarë).

Në Parlamentin Evropian KSČM kritikon hapur e me forcë dobësimin e përgjithshëm të standardeve sociale dhe para së gjithash Marrëveshjen mbi Kushtetutën e Evropës, e cila favorizon pozicionin e vendeve më të mëdha anëtare të BE-së. Ju këmbëngulni, që identiteti kombëtar dhe të drejtat e barabarta të vendeve të veçanta të BE-së nuk duhen prekur për asnjë arsye.

Deputetët/et e të Majtës së Bashkuar Evropiane nga Greqia në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian

Greqia dhe zgjerimi në drejtim të Lindjes – Pozicioni i Partisë Komuniste

Partia Komuniste e greqisë (KKE) u themelua më 1918 dhe u ngrit që në fillim mbështetur mbi klasën e vogël punëtore tradicionale. Ajo u deklarua për një program të ngurtë ideologjik dhe një strukturë fikse organizative. Objektivi i saj kryesor është shndërrimi revolucionar i shoqërisë greke përmes luftës kundër kapitalizmit dhe zbatimit të socializmit dhe komunizmit. Thelbin e KKE e formojnë punëtorët, nëpunësit, akademikët dhe studentët.

KKE ka qenë kundër anëtarësimit të Greqisë në Bashkimin Evropian. Ajo ishte partia e vetme, që votoi kundër Traktatit të Maastricht-it dhe zgjerimit në drejtim të Lindjes së Bashkimit Evropian. BE konsiderohet nga KKE si një bashkim kapitalesh evropiane, që gjendet nën drejtimin e tre-katër fuqive të mëdha, në krye të të cilave gjendet Gjermania. Në këtë mënyrë BE shkon, në gjykimin e KKE, kundër objektivave komuniste dhe socialiste të kësaj të fundit.

Në lidhje me zgjerimet e planifikuara të BE-së KKE mban një qëndrim tejet refuzues. Ajo kërkon të ndalojë me çdo kusht shtrirjen e konsideruar imperialiste të BE-së kapitaliste, në të mirë të klasës punëtore të vendeve kandidatë për anëtarësim. Në zgjedhjet parlamentare greke të zhvilluara në shtator 2007 Partia Komuniste e Greqisë mori 22 vende (më parë vetëm 12) nga gjithsej 300 vende të mundshme, duke zënë kështu vendin e partisë së tretë më të fuqishme në vend, pas partisë konservative „Demokracia e re“ me 152 vende dhe Partisë Socialiste PASOK me 102 vende. Ndërsa në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2004 Partia Komuniste e Greqisë mori 9,1% të votave duke u përfaqësuar kështu nga 24 deputetë grekë në Parlamentin Evropian.

Taktika:

Si deputet/e i/e një partie me qëndrime kundërevropiane Ju jeni në mënyrë strikte kundër çdo zgjerimi të mundshëm të Bashkimit Evropian. Ju refuzoni në mënyrë kategorike ndërhyrjet imperialiste dhe shtrirjen eventuale të BE-së në Ballkan dhe në rajonin e Detit Mesdhe.

Çështja e Qipros është për Ju një rast pushtimi turk brenda territorit të një shteti sovran dhe të pavarur. Për këtë arsye, Ju gjykoni që problematika e Qipros duhet zgjidhur sipas të drejtës ndërkombëtare dhe me anë rezolutash të Kombeve të Bashkuara, por jo në kuadër të politikës së jashtme të BE.

Edhe në lidhje me angazhimin e Bashkimit Evropian për Kosovën Ju shprehni shqetësimet Tuaja, duke qenë se edhe këtu ka një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, që duhet parë si e detyrueshme për tu zbatuar.

Përsa i përket konfliktit (debatit për emrin) mes qeverisë maqedonase dhe asaj greke Ju merrni një pozicion ndërmjetës me tendencë pro-maqedonase. Maqedonia jugosllave ka mbështetur gjatë luftës civile greke 1947-1949 komunistët grekë, që më vonë rezultuan humbës, në luftën kundër grekëve besnikë të mbretit. Ky fakt historik ka mbetur i paharrueshëm deri në ditët e sotme. E megjithatë Ju kërkonit ta „mbronit“ Maqedoninë nga anëtarësimi në BE dhe deklaroheni kundër pranimit të saj.

Në parim, Ju jeni kundër Evropës së konsoliduar me të drejta të zgjeruara vendimmarrjeje. Përkundrazi Ju kërkonit një kthim të kompetencave evropiane në nivel kombëtar.

Kërkonit para së gjithash shkëmbime mendimesh më parlamentarë grupimesh të tjera radikale në Parlamentin Evropian.